



Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri

**Raport i Kolegjit Universitar Pavarësia
Vlorë
Qershor 2017**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm të Jashtëm:

- | | | |
|---|--------------------|---------|
| 1 | Profesor Mark Hunt | Kryetar |
| 2 | Znj. Mandy Hobart | Anëtare |
| 3 | Dr. Benita Starve | Anëtar |

Data: 1 deri më 2 qershor 2017

Përmbajtja

Konteksti i këtij vlerësimi	2
Raporti i përmbledhur.....	3
Përmbledhje e gjetjeve.....	5
Raporti i detajuar.....	8
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij	8
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet	13
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula	18
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....	23
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	27
Lista e dokumenteve	31

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi i përgjithshëm i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë në çfarë shkalle IAL-ja përmbush Standardet Shtetërore Shqiptare të Cilësisë, të hyra në fuqi në vitin 2011.

Vlerësimi i jashtëm institucional është një proces i vlerësimit me ekspertë të jashtëm, ku çdo grup ekspertësh përbëhet nga ekspertë të Mbretërisë së Bashkuar, të caktuar nga QAA-ja, dhe nga ekspertë shqiptarë të caktuar nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm drejtohet nga një ekspert i QAA-së.

Raportet përfundimtare do të shërbejnë jo vetëm për akreditimin institucional, bazuar në shkallën e përmbushjes së Standardeve nga IAL-ja, por edhe për të informuar IAL-të, qeverinë shqiptare, publikun dhe studentët, se si IAL-ja i përmbush Standardet. Ky raport, i ndihmon gjithashtu IAL-të që të identifikojnë përparësitë për përmirësime (procesi që ofruet e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxënit të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar nën pesë Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave më të mira, rekomandimet, pohimet e veprimtarisë në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush Standardet. Format e gjykimit që ekspertët mund të japin janë: Standardet janë përmbushur plotësisht; Standardet janë përmbushur kryesisht; Standardet janë përmbushur pjesërisht; ose Standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar Këshillit të Akreditimit të APAAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur
Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht
Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht
Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, QAA-ja ka siguruar ekspertë mbështetës për Grupin e Vlerësimit të Jashtëm duke siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe për korrektimin dhe përmbledhjen e raportit të plotë për përmbledhjen më poshtë.

Konteksti i këtij vlerësimi

Kolegji Universitar “Pavarësia Vlorë” është një Kolegji Universitar privat që ndodhet në Vlorë, Shqipëri i themeluar në vitin 2007 [Ligji Nr. 9741, datë 21.05.2007 - Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, dhe i licencuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 279, datë 12.03.2009 - Për dhënien e lejes për Shkollën Private të Arsimit të Lartë Pavarësia - Me Urdhrin nr. 238 - datë 30.04.2010] dhe i është dhënë leja për hapjen e programeve të ciklit të parë, si vijon: Bachelor në Drejtësi; Bachelor në Ekonomi; Bachelor në Shkencat Politike; Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike dhe Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (IDSL) në Arkitekturë. Kolegji Universitar u licencua për hapjen e programeve të studimeve të ciklit të dytë në vitin 2011 [Urdhri nr. 388 - datë 10.08.2011 - MAS - në bazë të vendimit nr. 149 datë 18.02.2011 të Këshillit të Akreditimit] në Master Profesional [Specialist i të drejtës së shoqatave tregtare/Specialist e të drejtës së sistemit bankar/Specialist në të drejtën e administratës publike/Financa dhe Banka/Administrimi i sistemeve dhe rrjeteve/Specialist për programim të sistemit softuer] dhe Master i Shkencave [E drejta private dhe e drejta ndërkombëtare private /E drejta publike dhe administrative/Studime Evropiane/Diplomacia dhe politika ndërkombëtare/Inxhinieri Kompjuterike/Informatikë Ekonomike]. [12]

Misioni i Kolegjit Universitar, i cili përshkruhet në Planin Strategjik 2015-2020, ka për qëllim “Formimin e studiuesve dhe specialistëve të rinj në fushën e së drejtës, ekonomisë, shkencave politike, inxhinierisë kompjuterike, arkitekturës, edukimit fizik dhe sportit, inxhinierisë elektronike dhe elektrike, teknologjisë së informacionit, mekatronikën inxhinierike të softuerit, menaxhimit të projektimit të biznesit, menaxhimit të turizmit dhe turizmit mjedisor, legjisacionit mjekësor, administrimit dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, ligjit të noterisë dhe ligjit të pronësisë dhe marrëdhënieve me publikun”. [12]

Misioni mbështetet nga një sërë vlerash dhe parimesh që përfshijnë: zhvillimin e nivelit akademik sipas standardeve kërkimore dhe mësimore; zhvillimin dhe mbrojtjen e njohurive; ofrimin e arsimit të lartë në një game të gjerë lëndësh; promovimi i inovacionit dhe të menduarit kritik; ofrimin e një mjedisi të larmishëm intelektual dhe rritjen e bashkëpunimit dhe komunikimit me kërkuesit në nivel ndërkombëtar; metodat e mësimdhënies të konceptuara, për të mbështetur dhe promovuar krijimtarinë e studentëve; dhe trajnime praktike në bashkëpunim me institucionet publike dhe private. [12]

Kolegji Universitar ka dy fakultete: Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Fakultetin e Ekonomisë dhe Shkencave Sociale, katër departamente (Inxhinieri Informatike, Arkitekturë, Ekonomi dhe Drejtësi, dhe Shkenca Politike) dhe dy njësi kërkimore (Shkencat Humane dhe të Aplikuara). [001] Kolegji Universitar ofron programe të ciklit të parë dhe të dytë të zhvilluara në gjuhën shqipe dhe ofron katër diploma të nivelit Bachelor, të cilat zakonisht zgjasin tre vjet. Ai gjithashtu ofron një program të nivelit Master Profesional, i cili zgjat 1-1,5 vjet dhe pesë programe të nivelit Master të Shkencave, që zgjasin 2 vjet, dhe një program Master Profesional (Program i Integruar Studimi) i cili zgjat 5-6 vjet. Në vitin akademik 2016-17 numri i studentëve të regjistruar ishte si vijon: 257 studentë në ciklin e parë dhe 140 studentë në ciklin e dytë. Kolegji Universitar aktualisht nuk ka studentë joshqiptarë të regjistruar në programet e tij. Kolegji Universitar aktualisht (2016-2017) ka të punësuar 42 punonjës me kohë të plotë, 12 vetë staf akademik me kohë të pjesshme dhe 10 vetë personel administrativ. [001]

Kolegji Universitar ka vendosur tri sfida kryesore për veten gjatë pesë viteve të ardhshme. Së pari, të jetë një lider rajonal i arsimit të lartë, përfshirë dhe përmirësimin e renditjes së Kolegjit Universitar në vend, së dyti, synimin për të qenë një institucion kërkimor intensiv i arsimit të lartë dhe së treti, integrimin e njohurive teorike me përvojën praktike në mësimdhënie dhe mësimnxënie. [12]

Raporti i përmbledhur

Raporti i Vetëvlerësimit u përgatit nga një grup në Kolegji Universitar që përfshinte drejtues të lartë, staf akademik dhe personel mbështetës dhe një përfaqësues të studentëve. Projektraportet iu shpërndanë një audience të gjerë brenda Kolegjit Universitar para se të përmbylleshin dhe miratoheshin nga rektori dhe grupi që përgatiti raportin e vetëvlerësimit.

Vizita u zhvillua për dy ditë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga dy ekspertë britanikë me përvojë në arsimin e lartë dhe një anëtar me përvojë në arsimin e lartë nga stafi i një institucioni shqiptar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet nga një drejtues i vlerësimit dhe një person për mbajtjen e shënimeve siguruar nga APAAL-, agjencia përgjegjëse për vlerësimin e arsimit të lartë në Shqipëri. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u pajis me një Raport Vetëvlerësimi dhe një portofol të dokumenteve mbështetëse tetë javë përpara vizitës së vlerësimit, të cilat dhe u plotësuan me dokumentacion shtesë të kërkuar. Në tërësi, janë shqyrtuar rreth 129 dokumente që i kanë mundësuar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm të njihet me strukturën, politikën, procedurat e administrimit dhe natyrën e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore të ndërmarrë nga Kolegji Universitar. Dokumentet e shqyrtuara përfshinin Statutin e Kolegjit Universitar, rregulloret akademike, raportet vjetore, procedurat e pranimit dhe orientimit, gamën e marrëveshjeve me jashtë dhe shembuj të informacionit të programit dhe procesverbale nga diskutimet e mbledhjeve vendimmarrëse.

Gjatë dy ditëve të vizitës së vlerësimit u zhvilluan një serë takimesh, gjë që i lejoi Grupit të Vlerësimit të Jashtëm të krijonte një pikëpamje më të qartë të përgjegjësive, procedurave dhe pikëpamjeve të stafit dhe studentëve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me Rektorin, drejtuesit e lartë, pedagogët, studentët dhe personelin administrativ dhe atë mbështetës. U mbajtën shënime me shkrim në të gjitha mbledhjet. Si pjesë e një vizite në kampusin, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi bibliotekën, auditorët dhe laboratorët e TI-së dhe pa një demonstrim të sistemit informativ elektronik dhe faqes së internetit të Kolegjit Universitar për stafin dhe studentët. Duke shqyrtuar të gjitha dëshmitë në dispozicion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti në përfundimet e paraqitura më poshtë.

Kolegji Universitar i përmbush standardet kryesisht për Organizimin dhe Menaxhimin e tij. Përgjegjësitë për organizimin dhe administrimin e Kolegjit Universitar janë të përcaktuara në Statut dhe Rregullore. **[1; 2; 3]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi praktikën e mirë në strategjinë e Kolegjit Universitar për bashkëpunim me partnerët vendorë, që ka identifikuar prioritetet në mbështetje të ekonomisë vendore të Vlorës, dhe ka çuar në hapjen e programeve për të përmbushur nevojat e tregut vendor të punës. U identifikuan dobësi në zbatimin e rolit të Dekanëve të Fakultetit në lidhje me Statutin e ri dhe rregulloret e arsimit të lartë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që roli i dekanëve të fakulteteve të zbatohet në përputhje me rregulloret dhe statutin e miratuar të Kolegjit Universitar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi që Kolegji Universitar duhet të zbatojë plotësisht statutin dhe rregulloret e miratuara, për shembull në lidhje me zgjedhjen e drejtuesve në poste të larta.

Kolegji Universitar i përmbush kryesisht standardet për Burimet. Burimet aktuale janë gjerësisht të përshtatshme për të përmbushur kërkesat mësimore të studentëve, përfshirë akses në kompjuter dhe sisteme të komunikimit online. Institucioni ka ngritur kohët e fundit një Bord të Administrimit, për të përmbushur kërkesat ligjore të administrimit financiar dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i pohon veprimet aktuale me qëllim mbështetjen e transparencës më të madhe në menaxhimin e buxheteve. Ndërtesa në të cilën ndodhet Kolegji Universitar nuk i përmbush të gjitha kërkesat ligjore për sa i përket daljeve të emergjencës në rast zjarri, dhe ndriçimit, që janë identifikuar si një dobësi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që daljet e emergjencës dhe kërkesat e ndriçimit duhet të trajtohen në përputhje me kërkesat ligjore.

Kolegji Universitar i përmbush kryesisht standardet për Kurrikulën. Misioni i Kolegjit Universitar përqendrohet në një kurrikul që mbështet përparësitë vendore dhe kombëtare të tregut të punës. [12] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi praktikën e mirë në sistemin e mirëzbatuar të praktikave dhe bashkëpunimin me tregun vendor të punësimit në Vlorë, që mbështet mundësitë e punësimit të studentëve pas diplomimit. Disa programe të studimeve të ciklit të dytë nuk janë të licencuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, edhe pse studentët ishin të regjistruar në këto programe, gjë që paraqitet si dobësi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon si çështje urgjente që Kolegji Universitar dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit të bashkëpunojnë për të zgjidhur çështjen e pazgjidhur të licencimit, në mënyrë që studentët e regjistruar të diplomohen. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon zbatimin e qasjes së Kolegjit Universitar ndaj partneritetit me institucionet jashtë shtetit, për shembull Erasmus +, dhe zhvillimin e trajnimeve për gjuhët e huaja, në gjuhën angleze dhe italiane.

Kolegji Universitar i përmbush pjesërisht standardet për Mësimdhënie, Mësimnxënie, Vlerësim dhe Kërkim. Përgjegjësitë për menaxhimin e mësimdhënies, mësimnxënies, vlerësimit dhe kërkimit janë përcaktuar në Planin e Zhvillimit Strategjik 2015-2020. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë. Janë identifikuar dobësitë si më poshtë: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk arriti të vinte re një politikë të qartë në nivelin e Kolegjit Universitar që të promovonte në mënyrë strategjike përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit. Përveç kësaj, qasja e Kolegjit Universitar për kërkim shkencor është në një fazë të hershme zhvillimi dhe aktualisht i mungon një qasje e menaxhimit institucional për kërkim shkencor dhe strukturat për zhvillimin e prioritetëve, për të rritur profilin e tij vendor dhe kombëtar të kërkimit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që Kolegji Universitar të zhvillojë dhe zbatojë në nivel institucioni një politikë për përmirësimin e mësimdhënies së stafit dhe cilësisë së mësimnxënies dhe të zhvillojë një qasje strategjike për menaxhimin, zbatimin dhe përparimin e prioritetëve të kërkimit në nivel institucional. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi zgjerimin e infrastrukturës së bibliotekës së Kolegjit Universitar, për të mbështetur të gjitha programet e studimit dhe për të mbështetur mësimdhënien, mësimnxënien dhe vlerësimin.

Kolegji Universitar i përmbush plotësisht standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre. Studentët kanë akses në një gamë të gjerë informacionesh për programet, që janë të publikuar në faqen e internetit të Kolegjit Universitar. Angazhimi i studentëve në menaxhim bëhet nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur në Këshillin Studentor, të cilët përfaqësojnë zërin e studentëve në komisionet kryesore, përfshirë Senatin Akademik. Aktivitetet e organizuara nga Këshilli Studentor mbështeten financiarisht nga Kolegji Universitar dhe studentët nxiten gjithashtu të marrin pjesë në projekte të jashtme. Janë dhënë informacione të qarta mbi mundësitë e praktikës nga Zyra e Karrierës, Tutoriatit Studentor dhe Alumnit, e cila gjithashtu mban kontakte me të diplomuarit dhe mbështet studentët për të gjetur vende pune. Burimet e bibliotekës në kampus plotësohen nga aksesimi në bibliotekat e afërta publike dhe të institucioneve të tjera. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë praktikë të mirë apo dobësi, nuk dha rekomandime dhe nuk bëri pohime.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- strategjia e Kolegjit Universitar për bashkëpunimin me partnerët vendorë, që ka identifikuar prioritetet në mbështetje të ekonomisë vendore të Vlorës dhe ka çuar në hapjen e programeve në përputhje me tregun vendor të punës (pika 1.14; **Kapitulli III Standardi III.3**)
- sistemi i mirëzhvilluar i praktikave dhe bashkëpunimi me tregun vendor të punësimit në Vlorë, që mbështet mundësitë e punësimit të studentëve pas diplomimit (pika 3.12; **Kapitulli I Standardi I.7; Kapitulli I Standardi I.11; Kapitulli I Standardi I.12**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- Kolegji Universitar aktualisht nuk është në gjendje të tregojë që roli i dekanëve dhe funksioni i fakulteteve është i integruar, në mënyrë që të sigurohet vendimmarrja kolegjiale në përdorimin e burimeve njerëzore dhe materiale (pika 1.10; **Kapitulli III Standardi II.1; Kapitulli III Standardi I.2; Kapitulli III Standardi II**)
- konfigurimi i ndërtesës aktuale pasi nuk i përmbush të gjitha kërkesat rregullatore për ndriçimin dhe daljet e emergjencës (pika 2.11; **Kapitulli III Standardi VII.1**)
- zhvillimi i disa programeve të studimit të ciklit të dytë, dhe regjistrimi i studentëve në ato programe, pa pasur licencat përkatëse nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (pika 3.2; **Kapitulli I Standardi I.1**)
- Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk arriti të vërente një politikë të qartë në nivelin e Kolegjit Universitar, e cila promovonte në mënyrë strategjike përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit (pika 4.5; **Kapitulli II Standardi I.3; Kapitulli II Standardi I.4**)
- Qasja e Kolegjit Universitar ndaj kërkimit është në një fazë të hershme zhvillimi dhe aktualisht i mungon një qasje institucionale ndaj kërkimit dhe strukturave për zhvillimin e prioritetëve dhe rritjen e profilit vendor dhe kombëtar të kërkimit (pika 4.11; **Kapitulli II Standardet I.1-8**).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Kolegji Universitar, duke filluar nga fillimi i vitit akademik 2017-18, të sigurojë që roli i dekanëve të fakulteteve të zbatohet në pajtim me rregulloret dhe statutin e miratuar të Kolegjit Universitar (pika 1.10; **Kapitulli III Standardi II.1; Kapitulli III Standardi I.2; Kapitulli III Standardi II.1**)
- Kolegji Universitar të shqyrtojë kërkesat për ndriçimin dhe daljet e emergjencës në përputhje plotësisht me rregulloret për fillimin e vitit akademik 2017-2018 (pika 2.11; **Kapitulli III Standardi VII.1**)
- në mënyrë urgjente, Kolegji Universitar dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit duhet të bashkëpunojnë për të zgjidhur çështjen pezull të licencimit, në mënyrë që studentët e regjistruar të mund të diplomohen (pika 3.2; **Kapitulli I Standardi I.1**)
- Kolegji Universitar gjatë vitit akademik 2017-2018 të zhvillojë dhe zbatojë një politikë për përmirësimin e mësimdhënies të stafit dhe cilësisë së të nxënies (pika 4.5; **Kapitulli II Standardi I.3; Kapitulli II Standardi I.4**)

- Kolegji Universitar gjatë vitit akademik 2017-2018 të zhvillojë një qasje strategjike për menaxhimin, zbatimin dhe përparimin me prioritetet e kërkimit në nivel institucional (pika 4.11; **Kapitulli II Standardi I.1-8**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet e mëposhtme në proces:

- Kolegji Universitar të zbatojë plotësisht Statutin dhe Rregulloret e miratuara, për shembull, në lidhje me zgjedhjen e drejtuesve në poste të larta (pikat 1.1, 1.5; **Kapitulli III Standardi I.1; Kapitulli III Standardi I.2**)
- ngritja e Bordit të Administrimit do ta ndihmojë Kolegjin Universitar të mbështesë zhvillimin dhe transparencën e menaxhimit financiar (pika 2.6; **Kapitulli III Standardi VII.1; Kapitulli III Standardi VII.2; Kapitulli III Standardi VI.1**)
- zbatimi i qasjes së Kolegjit Universitar ndaj partneritete me institucionet jashtë shtetit, për shembull me Erasmus +, dhe zhvillimi i trajnimeve për gjuhët e huaja, në gjuhën angleze dhe italiane (pikat 3.8 dhe 3.16; **Kapitulli I Standardi I.4; Kapitulli I Standardi I.10**)
- zgjerimi i sferës së infrastrukturës së bibliotekës, për të mbështetur të gjitha programet e studimit dhe për të mbështetur mësimdhënien, mësimnxënien, vlerësimin e studentëve (pika 4.1; **Kapitulli I Standardi II.1; Kapitulli I Standardi II.3**).

Përmbledhje e Gjytimeve për çdo Fushë Vlerësimi

- 1 Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përmbushur kryesisht.**
- 2 Standardet për Burimet janë **përmbushur kryesisht.**
- 3 Standardet për Kurrikulën janë **përmbushur kryesisht.**
- 4 Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përmbushur pjesërisht.**
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përmbushur plotësisht.**

Gjykimi i përmbledhur

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon Këshillit të Akreditimit se në Kolegjin Universitar Pavarësia Vlorë, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë **përmbushur kryesisht.**

Raporti i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

1.1 Kolegji Universitar "Pavarësia Vlorë" u themelua në vitin 2009 si një Shkollë e Lartë Private dhe u licencua për ofrimin e programeve universitare në Drejtësi, Ekonomi, Shkencat Politike, Inxhinieri Informatike dhe një Diplome të Integruar në Arkitekturë. **[002 fq.4; M1]** Ofrimi i programeve pasuniversitar në nivelin Master dhe Master i Shkencave u licencua në vitin 2011. Deri në dhjetor të vitit 2016, institucioni kishte vepruar sipas statutit të mëparshëm. **[1 Shënim 1]** Statuti i ri u miratua në dhjetor të vitit 2016 **[2 Shënim 2 & Ligji i ri nr. 80/2015]** plotësisht në përputhje me misionin dhe qëllimet e Kolegjit Universitar dhe zbatohet në të gjitha departamentet. **[002 fq.6]** Rregulloret e brendshme **[3 Shënim 3]** u miratuan në vitin 2012 dhe rregullojnë veprimtaritë mësimore, shkencore dhe administrative të institucionit. Rregulloret përcaktojnë strukturat, organet drejtuese dhe autoritetet në aspektin e menaxhimit të institucionit. **[002 fq.7]** Kolegji Universitar është ende në proces të zbatimit të statutit dhe rregulloreve të miratuara, për shembull për sa i përket zgjedhjes dhe emërimit të drejtuesve në poste të larta. Rrjedhimisht, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohon** se Kolegjit Universitar i zbaton plotësisht Statutin dhe Rregulloret e miratuara, për shembull, për sa i përket zgjedhjes së drejtuesve në poste të larta (shih gjithashtu pikën 1.5) **[001; 38; 130] [ESG 1.8 Informacion Publik, Kapitulli III Standardi I.1]**

1.2 Kolegji Universitar ka një strukturë të qartë për organizimin dhe menaxhimin e vet, siç përcaktohet në statutin e tij. **[1; 2]** Senati Akademik është organi i lartë vendimmarrës që vendos për planifikimin strategjik në fushat e arsimit, kërkimit dhe administrimit. **[M2]** Senati Akademik kryesohet nga rektori dhe anëtarësia përfshin dekanët e Fakultetit, përfaqësuesit e zgjedhur nga stafi akademik dhe një përfaqësues të zgjedhur nga studentët. **[1; 13]** Rektorati, komiteti i lartë drejtues, kryesohet nga rektori dhe anëtarët përfshijnë zëvendësrektorin, dekanët e fakulteteve dhe administratorin e Kolegjit. Përgjegjësitë e tij përfshijnë zbatimin e vendimeve të Senatit Akademik, përgatitjen e planit të zhvillimit, përgjegjësinë për politikën buxhetore, rekomandime për projekte të reja, miratimin e programeve të reja të studimit, strategjinë e kërkimit dhe çdo ndryshim strukturor të propozuar. Propozimet shqyrtohen nga Senati, ndërsa Rektori miraton procedurat, afatet dhe grupet e punës. **[4 Shënim 4; 002 fq.7]** Fakultetet miratojnë propozime në bazë të planeve të departamenteve në lidhje me numrin e programeve të studimit, ciklet e studimit dhe numrin e studentëve. **[M5]** Megjithatë, në kohën e vlerësimit, fakultetet ishin ende në funksion, pasi ishin planifikuar të fillonin në shtator të vitit 2017 (shih pikën 1.10). Detajet për shërbimin e ofruar të Kolegjit Universitar, kërkimin dhe botimet u vihen në dispozicion të gjithë palëve të interesit, nëpërmjet faqes së internetit të Kolegjit Universitar. **[M0; 131]**

1.3 Bordi i Administrimit **[2 Neni 29; 78]** është organi vendimmarrës që siguron qëndrueshmërinë financiare të Kolegjit Universitar dhe siguron mbikëqyrjen e çështjeve administrative, financiare, ekonomike dhe pronësore. **[002 fq.7; M3; M5; M6]** Këshilli i Etikës **[2 Neni 23; M0]** miratuar nga Senati Akademik është themeluar që prej vitit 2012. Ai shqyrton çështjet etike të jetës akademike, si dhe bën dhe paraqet propozime për Rektorin. Çështjet e shqyrtuara përfshijnë konfliktet ndërmjet stafit akademik, ankesave të studentëve dhe sjelljes joetike gjatë procesit zgjedhor. **[002 fq.8; 5 - Shënim 5]** Dekanatet e Kolegjit **[2 Neni 19]** kanë zëvendësuar Këshillat e Fakultetit, si një organ ekzekutiv që shqyrton propozimet nga departamentet, për sa i përket programeve të reja, shpërndarjes së burimeve njerëzore dhe ambienteve, propozimeve për projektbuxhetin, duke bërë rekomandime për projekte dhe kërkim shkencor.

1.4 Kolegji Universitar ka zhvilluar një sërë mekanizmesh për të mbështetur stafin akademik që të marrë pjesë në veprimtari të zhvilluara në vend dhe jashtë shtetit, përfshirë: shpalljen e mundësive të kërkimit në faqen e internetit; ditë informimi për promovimin e

projekteve; aktivitete të brendshëm trajnimi; një revistë shkencore të brendshme e botuar dy herë në vit, duke bërë të mundur që stafi të publikojë kërkimet e tyre, **[7 Shënimi 7]** dhe organizimin e konferencave shkencore brenda dhe jashtë vendit për stafin që të prezantojnë kërkimet e tyre. **[8 Shënimi 8; 002 fq.8; 88]**

1.5 Në lidhje me çështjet akademike Rektori është autoriteti më i lartë ligjor i institucionit. Gjatë vlerësimit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është vënë në dijeni se nuk janë zhvilluar ende zgjedhjet për drejtuesit në poste të larta, siç tregohet në Raportin e Vetëvlerësimit, për postin e rektorit, dekanët dhe përgjegjësit e departamenteve për shkak të rregullimeve aktuale kontraktuale. Megjithatë, sipas Statutit të miratuar në vitin 2016, në të ardhmen do të zgjidhen drejtuesit në postet e larta; institucioni pohoi se zgjedhjet do të zhvilloheshin në të ardhmen, në kohën që kontratat duhet të rinovoheshin. Kjo mbështet pohimin e përmendur në pikën 1.1. **[2 Neni 36, 40 dhe 44; 002 fq.9] [Kapitulli III Standardi I.2]**

1.6 Senati Akademik dhe të gjitha komisionet mbledhen mesatarisht dy herë në muaj, me kuorumin që bazohet në një të katërtën e anëtarësisë së përgjithshme. **[2 Neni 13]** Vendimet dhe propozimet nga mbledhjet u dërgohen strukturave përkatëse për të vijuar me zbatimin. Debatet dhe diskutimet me stafin zhvillohen në mbledhjet e departamenteve, drejtuar nga Përgjegjësi përkatës. Institucioni përdor të dhënat në përmbajtje të raportit vjetor, **[9 Shënimi 9]** për të monitoruar zbatimin e vendimeve. **[002 fq.9]** Axhendat dhe dokumentet për të gjitha mbledhjet u dërgohen anëtarëve paraprakisht (normalisht 7 ditë para), në mënyrë që dokumentet të mund të shqyrtohen nga anëtarët, të cilët mund të kontribuojnë në mbledhje, nëpërmjet debatit konstruktiv dhe vendimmarrjes. **[002 fq.9] [Kapitulli III Standardi I.3]**

1.7 Njësia e Cilësisë së Brendshme mbikëqyr pajtueshmërinë me legjislacionin, roli i saj është i pavarur dhe siguron zbatimin e legjislacionit dhe politikave. **[M0; M3; M6]** Qasja sistematike dhe e disiplinuar e NJSBC-së ka për qëllim të vlerësojë dhe të përmirësojë menaxhimin e proceseve të kontrollit të brendshëm. **[002 fq.9; 10; 3; 73; 131]** Programet universitare dhe pasuniversitare janë të konceptuara për të pasqyruar modelin Evropian të Sistemit të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), ndërsa një pjesë e programeve zhvillohen në gjuhën angleze, për të rritur mundësitë e punësimit. **[001; 9; 3]** Programet trevjeçare në Kolegjin Universitar bazohen në Deklaratën e Bolonjës dhe zbatohet një sistem kreditesh ECTS. **[M2]** Diplomat janë në gjuhën shqipe, por suplementi është në gjuhën angleze dhe shqipe, në mënyrë që kualifikimi të kuptohet jashtë Shqipërisë për qëllime arsimore dhe punësimi. **[11 Shënimi 11; 002 fq.10] [Kapitulli III Standardi I.4]**

1.8 Është ende në fuqi Plani i Zhvillimit Strategjik 2015-2020 që **[12 Shënimi 12]** është miratuar nga Senati Akademik. **[M3]** Plani është hartuar në përputhje me misionin dhe arritjen e qëllimeve strategjike të institucionit. Plani përcakton objektivat dhe veprimet për arritjen e tyre, së bashku me treguesit e performancës, për t'i matur ato. Objektivat strategjike përqendrohen në mësimnxënien dhe mësimdhënien e cilësisë së lartë, menaxhimin e cilësisë, kërkimin dhe zhvillimin, marrëdhëniet me komunitetin dhe partnerët, bashkëpunimet dhe komunitetet e qëndrueshme. **[M1]** Rezultatet e suksesshme publikohen në Raportin Vjetor dhe në Raportin për Veprimtaritë Kërkimore Shkencore në fund të çdo viti akademik. Raportet diskutohen në të gjithë institucionin. **[002 fq.10; 9] [Kapitulli III Standardi I.5]**

1.9 Raporti vjetor i Veprimtarive Arsimore, Kërkimore dhe Financiare **[9 Shënimi 9]** i dorëzohet Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit për miratim në dhjetor të çdo viti. **[2 Neni 9]** Rektori mban një mbledhje të hapur, ku përfaqësohet i gjithë stafi i Kolegjit Universitar, për të paraqitur dhe diskutuar raportin. Në fund të mbledhjes, miratohet Raporti Vjetor me vendimmarrje kolegjiale dhe një kopje i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. **[002 fq.10] [Kapitulli III Standard I.6; ESG 1.1 Politika për Sigurimin e Cilësisë]**

1.10 Kolegji Universitar organizohet në dy struktura paralele: **[13 Shënimi 13]** e para, administrata e qeverisur nga Bordi i Administrimit, e dyta përbëhet nga dy fakultete drejtuar nga Senati Akademik. Institucioni gëzon autonomi dhe liri akademike në mësimdhënie, kërkim, çështje organizative dhe financiare, siç përcaktohet në Statut. Institucioni ka kompetenca të mbledhë fonde, të bëjë marrëveshje të pavarura me institucionet dhe organizatat e biznesit, për të mbështetur studentët. **[002 fq.11]** Struktura e Kolegjit Universitar përbëhet nga dy fakultete: Fakulteti i Ekonomisë dhe Shkencave Sociale (FESHS) dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara (FSHA), si dhe gjashtë njësi themelore (departamente/qendra): Departamenti i Ekonomisë; Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike; Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike; Departamenti i Arkitekturës; Qendra Kërkimore e Shkencave Sociale; dhe Qendra Kërkimore e Shkencave të Aplikuara. Çdo fakultet ka dy departamente akademike dhe një qendër kërkimore. Kolegji Universitar ofron programe studimi në dy cikle; cikli i parë është hapur në vitin 2009; të dy fakultetet ofrojnë programe të ciklit të dytë në Masterin Profesional dhe Masterin e Shkencave. **[002 fq.11]** Megjithatë, gjatë vizitës së vlerësimit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u vu në dijeni se roli i dekanëve të Fakulteteve ishte në një fazë të hershme zbatimi për sa i përket Statutit të ri dhe rregulloreve për arsimin e lartë. Aktualisht Kolegji Universitar nuk mund të tregojë se roli i dekanëve dhe funksioni i fakulteteve është i ngulitur, në mënyrë të tillë që të sigurohet vendimmarrja kolegjiale në përdorimin e burimeve njerëzore dhe materiale; Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideroi këtë si një **dobësi**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që në fillim të vitit akademik 2017-2018, roli i dekanëve dhe i fakulteteve të zbatohet në përputhje me rregulloret dhe statutin e Kolegjit Universitar. **[Kapitulli III Standard II.1, Kapitulli III Standard I.2]**

1.11 Për sa i përket strukturës së stafit, **[14 Shënim 14]** të gjitha departamentet kanë të paktën tre persona me gradë shkencore dhe tituj dhe së paku shtatë anëtarë secili. Megjithatë, Departamenti i Informatikës u mbyll pasi nuk i përmbushte kërkesat. **[002 RVV fq.11 /12]**

1.12 Sipas statutit dhe rregullores aktuale, të gjitha komisionet dhe bordet e përhershme **[Bordi i Administrimit/Senati Akademik/Këshilli i Etikës/Bordi i Fakultetit dhe i Departamenteve]** veprojnë në bazë të diskutimeve dhe vendimmarrjes, nëpërmjet pjesëmarrjes së stafit. Të gjitha bordet mbledhen periodikisht dhe diskutojnë e debatojnë në përputhje me përgjegjësitë e tyre të shkruara. **[002 fq.12] [71; M5; 131] [Kapitulli III Standardi II.3]**

1.13 Kolegji Universitar informohet për zhvillimin ekonomik vendore, nëpërmjet konferencave kërkimore të zhvilluara nga departamentet. **[M4]** Institucioni ka Zyrën e Karrierës, Tutoriatit Studentor dhe Alumni, për të monitoruar dhe ndjekur punësimin e të diplomuarve të vet. **[M2; M6]** Deri më sot, monitorimi ka qenë i kufizuar në krijimin e një baze të dhënash të të diplomuarve me të cilët duhet komunikuar. Për të zhvilluar dhe përshtatur programet e studimit në përmbushje të nevojave të tregut të punës, institucioni kryen studimin e tregut të punës në fushat e tij të studimit. **[117; M1]** Ky studim është ndërmarrë në nivelin e departamentit, për shembull studimi i tregut është kryer në një fushë e re e mundshme studimi: Edukimi fizik dhe Sportet në nivelin Bachelor në fushën e edukimit fizik. **[M3; 002 fq.13]** Megjithëse kjo ka dhënë një shembull për Grupin e Vlerësimit të Jashtëm, duket se studimi i tregut të programit është disi i posaçëm dhe nuk është miratuar në të gjitha nivelet e Kolegjit Universitar. **[002 fq.13]** Për mbledhjen e të dhënave të të diplomuarve, faqja e internetit tani ka një pyetësor online në lidhje me punësueshmërinë, që studentët mund ta plotësojnë. **[15/98 Pyetësori për Alumni - Shënimi 15; www.unipavaresia.edu.al] [ESG 1.8 Informacion Publik] [Kapitulli III Standardi III.1]**

1.14 Kolegji Universitar dëshiron të angazhohet në mënyrë aktive në aktivitete partneriteti, përfshirë edhe mbështetjen e stafit që të marrë pjesë në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, **[M1; 89]** përfshirjen në projekte ndërkombëtare. Stafi nxitet në mënyrë

aktive që të publikojë kërkimet e tyre në revista shkencore, përfshirë edhe revistën shkencore “Pavarësia”. [M5] Stafit i ofrohet gjithashtu mundësi për të kryer vizita dhe për t’u angazhuar në trajnime jashtë vendit. [18; 19; 17; 7] Veprimtaria bashkëpunuese dhe partneriteti i institucionit është përcaktuar qartësisht në Planin e Zhvillimit Strategjik. [12] Kolegji Universitar bashkëpunon me institucione të ndryshme në lidhje me angazhimin e studentëve në praktikën profesionale dhe trajnime. Ai synon të krijojë marrëdhënie të qëndrueshme partneriteti, për shembull, disa marrëveshje janë me: Bashkinë e Vlorës; Autoritetin Portual Vlorë; Zyrën e Vlorës për Mbrojtjen e Konsumatorit; Dhomën e Tregtisë Vlorë; dhe Qendrën Kombëtare EPICT të FIB Bank. [16; 002 fq.13] Kolegji Universitar ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë Shqipërisë [17], qëllimi kryesor i të cilave është shkëmbimi i stafit akademik dhe studentëve, për shembull me Kolegjin Universitar Sapienza dhe Kolegjin Universitar European të Tiranës. [103 Shënim 18; 002 fq.13; M5] Strategjia e Kolegjit Universitar për bashkëpunimin me partnerët vendorë, që ka identifikuar prioritetet në mbështetje të ekonomisë vendore të Vlorës dhe që ka çuar në hapjen e programeve, për të përmbushur nevojat e tregut vendor të punës, konsiderohet si **praktikë e mirë** [50; 65; 130; M4] [Kapitulli III Standard III.2; Kapitulli III Standardi III.3; Kapitulli III Standardi III.4]

1.15 Në mbështetje të mobilitetit të stafit dhe studentëve, Kolegji Universitar mori pjesë në “Enchase”. [19 Zhvillimi i Sistemit Shqiptar të Sigurimit të Cilësisë në AL: Zbatimi i Metodologjisë së Procesit dhe të Rezultateve - 2013-2016] Projekti mundësoi mobilitetin vjetor të stafit dhe studentëve në një shkollë verore në Kolegjin Universitar e Koblenzit. [002 fq.14; M5] Stafi informohet rreth thirrjeve të mundshme për aplikime në projekte, nëpërmjet informacioneve, posterave të afishuar dhe faqes zyrtare të internetit (www.unipavaresia.edu.al). Kolegji Universitar ka një program aktiv për angazhimin e lektorëve të ftuar, personaliteteve të shquara dhe ish zyrtarëve të lartë nga administrata shtetërore. Fakultetet ftojnë rregullisht lektorë të huaj për zhvillimin e mësimdhënies institucionale. [002 fq.14] [Kapitulli III Standardi III.4]

1.16 Përgjegjësitë për organizimin dhe menaxhimin e Kolegjit Universitar janë të përcaktuara në Statut dhe Rregullore. [1; 2; 3] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm në strategjinë e Kolegjit Universitar identifikoi si praktikë të mirë bashkëpunimin me partnerët vendorë, që ka identifikuar prioritetet në mbështetje të ekonomisë vendore të Vlorës dhe që ka çuar në hapjen e programeve, për të përmbushur nevojat e tregut vendor të punës. U identifikuan dobësi në zbatimin e rolit të Dekanëve të Fakulteteve në lidhje me Statutin e ri dhe rregulloret e arsimit të lartë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që roli i dekanëve të fakulteteve të zbatohen në përputhje me rregulloret dhe statutin e Kolegjit Universitar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi se Kolegjit Universitar duhet të zbatojë plotësisht statutin dhe rregulloret e miratuara, për shembull në lidhje me zgjedhjen e drejtuesve në poste të larta.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Strategjia e Kolegjit Universitar për bashkëpunimin me partnerët vendorë, që ka identifikuar prioritetet në mbështetje të ekonomisë vendore të Vlorës dhe ka çuar në hapjen e programeve, për të përmbushur nevojat e tregut vendor të punës (pika 1.14; **Kapitulli III Standardi III.3**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- Roli i Dekanëve të Fakulteteve është në një fazë të hershme zbatimi sipas Statutit të ri dhe Rregulloreve të arsimit të lartë. Aktualisht Kolegji Universitar nuk mund të tregojë se roli i dekanëve dhe funksioni i fakulteteve është integruar në mënyrë që të sigurohet vendimmarrja kolegjiale në përdorimin e burimeve njerëzore dhe materiale (pika 1.10; **Kapitulli III Standardi II.1; Kapitulli III Standardi I.2; Kapitulli III Standardi II.1**).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- Kolegji, duke filluar nga fillimi i vitit akademik 2017-2018, të sigurojë se roli i dekanëve dhe i fakulteteve të zbatohet në pajtim me rregulloret dhe statutin e miratuar të Kolegjit Universitar (pika 1.10; **Kapitulli III Standardi II.1; Kapitulli III Standardi I.2; Kapitulli III Standardi II.1**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimin e mëposhtëm tashmë në proces:

- Kolegji Universitar të zbatojë plotësisht Statutin dhe Rregulloret e miratuara, për shembull, në lidhje me zgjedhjen e drejtuesve në poste të larta (pikat 1.1 dhe 1.5; **Kapitulli III Standardi I.1; Kapitulli III Standardi I.2**).

Gjykim

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

2.1 Kolegji Universitar ka mekanizma të qartë për rekrutimin e stafit që menaxhohen në përputhje me Statutin, Rregulloren dhe ligjin për arsimin e lartë. **[1; 3; M3]** Përshkrimet e pozicioneve të punës janë hartuar nga përgjegjësit e departamenteve dhe miratohen nga rektori para se të shpallen në faqen e internetit dhe në mediat vendore dy herë në vit. **[20; 3; 76; M5]** Procesi i rekrutimit dhe trajtimit të aplikimeve menaxhohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore, Marrëdhënive me Publikun dhe Shërbimeve. **[3; 20; M6]** Aplikantët plotësojnë një formular që mund ta gjejnë në faqen e internetit, ku përfshihen informacione për përvojën dhe kualifikimet e mëparshme. **[21; 3]** Aplikimet vlerësohen me pikë kundrejt kritereve të përzgjedhjes të dakorduara me departamentet, që është 60 për qind e procesit të përzgjedhjes. Kandidatët e përzgjedhur si staf akademik ftohen për një intervistë nga dekani dhe një komision i posaçëm i përzgjedhjes. **[20; 3; M6; M5]** Të gjitha informacionet nga dosja e aplikantit i vihen në dispozicion komisionit të përzgjedhjes, përfshirë verifikimin e informacionit të dhënë dhe rezultatet e kandidatëve kundrejt kritereve. Informacioni dhe rekomandimi për emërim i dorëzohet Rektorit për miratim. **[3; 20]** Kontratat e punës hartohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore në bazë të detyrave dhe përgjegjësisë dhe pagës së rënë dakord. **[22]** Të gjitha kontratat e stafit përfshijnë mbulimin e sigurimeve shëndetësore në përputhje me ligjin nr. 10 383. **[ESG 1.5 Stafi mësimdhënës; Kapitulli III Standardi IV.1]**

2.2 Punësimi i stafit me kohë të pjesshme dhe i lektorëve të ftuar menaxhohet në përputhje me rregullat ligjore dhe me kritere të përshtatshme, që pasqyrojnë nevojat e departamenteve. Kolegji Universitar kërkon të rekrutojë staf, të cilët, në disa raste, kanë studiuar jashtë vendit, kanë diploma më të arsimit të lartë dhe kanë përvojë pune si ekspertë në fushën e tyre. **[127; M3; M5]** Për shembull, Departamenti i Drejtësisë ka rekrutuar dy magjistratë si pedagogë me kohë të pjesshme, dhe fton stafin e Departamentit Juridik si lektorë të ftuar. **[24; M5; M2; M4]** Në vitin akademik 2016-2017, u rekrutuan 12 punonjës me kohë të pjesshme, shtatë nga të cilët janë specialistë të jashtëm dhe pesë prej tyre janë lektorë të ftuar. Strategjia për integrimin e njohurive teorike me praktiken shërben për të siguruar që studentët të kenë akses në mësimdhënien aktuale të specializuar e bazuar në praktikë. **[23; 14]** Rekrutimi menaxhohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe Kodin e Punës. **[3]** Kontratat nënshkruhen nga Rektori dhe stafi i ri akademik mentorohet për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre nga stafi i departamentit i caktuar për këtë qëllim. Termat dhe kushtet e punësimit përcaktohen në kontratë. **[1; 3; 22; M5]** **[Kapitulli III Standard II.2; Kapitulli III Standardi IV.1]**

2.3 Kolegji Universitar ka një strukturë të qartë për rekrutimin e stafit, me qëllim përmbushjen e kërkesave administrative dhe akademike. **[13; 14]** Departamentet akademike mbështeten nga funksionet administrative, duke përfshirë burimet njerëzore, financat, sekretarinë, bibliotekën dhe arkivin, marketingun dhe stafin e TI-së. Personeli aktual përfshin 42 vetë të stafit akademik me kohë të plotë me gradat përkatëse dhe 10 punonjës që punojnë në pozicione administrative dhe mbështetëse lidhur me veprimtaritë mësimore dhe kërkimore. **[14; 001;]** Çdo departament akademik përbëhet nga shtatë anëtarë të stafit, prej të cilëve të paktën tre kanë kryer kualifikimet e kërkuara dhe kanë marrë tituj akademik në përputhje me kërkesat ligjore të nenit 25 të ligjit për arsimin e lartë. **[13; 127]** Qendrat kërkimore pranë secilit fakultet, përqendrohen në kërkim shkencor që lidhet me lëndët, dhe stafi punon me projekte të jashtme dhe aktivitete të partneritetit, të cilat mbështesin realizimin e kurrikulës. Stafi akademik gjithashtu pritet të përdorë rezultatet e kërkimit të tyre, për të botuar të paktën dy artikuj në vit. **[18; 25; 11; 16]** **[Kapitulli III Standard IV.2]**

2.4 Njësia e Cilësisë është përgjegjëse për mbajtjen e regjistrave të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe performancës së përgjithshme të stafit. **[3; 10]** Procedurat

dhe kërkesat për vlerësimin e performancës dhe arritjeve të stafit janë të përcaktuara në rregullore dhe hartohen tabelat përmbledhëse të veprimtarive dhe përfshihen në raportin vjetor, i cili shqyrtohet dhe miratohet nga Senati Akademik. Kjo përfshin numrin e studentëve që përfundojnë kualifikimet e tyre, regjistrimet, angazhimin në projekte dhe analizën e anketimeve për sa të kënaqur ishin studentët. [25; 9; 1; 54] Njësia e Cilësisë gjithashtu ka marrë pjesë në një projekt cilësor evropian dhe ka punuar me studentët, për të marrë feedback shtesë për përvojat e tyre, dhe për të përgatitur një raport për drejtuesit e lartë, që lehtëson identifikimin e fushave për t'u përmirësuar. [74; M6; 80] Reagimet nga anketimet e studentëve tregojnë nivele të larta të kënaqësisë së përgjithshme për mësimdhënien, dhe për cilësinë e përgjithshme të burimeve. [54; 114; M2]

2.5 Puna me institucionet e jashtme është një prioritet dhe stafi nxitet të marrë pjesë në projekte me institucionet partnere dhe punëdhënës, si dhe në seminare dhe konferenca për të nxitur kërkimin dhe praktikën më të mira akademike. [25; 26] Stafi dhe studentët gjithashtu angazhohen në projekte vendore dhe kombëtare, përfshirë ato për dhunën në familje dhe sfidat e biznesit vendor. [19; M5] [Kapitulli III Standard IV.2; Kapitulli III Standardi IV.4]

2.6 Menaxhimi i burimeve financiare dhe buxheteve tashmë është i organizuar në përputhje me ligjin e ri për arsimin e lartë, i cili ka çuar në miratimin e një statuti të ri dhe në ndryshime të procedurave të Kolegjit Universitar dhe përgjegjësisë të menaxhimit të buxhetit. [1; 27; M3] Bordi i mëparshëm i Menaxhimit është zëvendësuar nga Bordi i Administrimit i cili u mbledh për herë të parë në maj të vitit 2017. Bordi i Administrimit përfaqëson autoritetin më të lartë administrativ vendimmarrës dhe kryesohet nga Administratori. [78; 5; M1] Sipas Statutit të ri dhe kërkesave rregullatore, Administratori është përgjegjës për hartimin e buxhetit në bazë të të dhënave nga departamentet dhe për menaxhimin e alokimit të burimeve pas miratimit të buxhetit. Përgjegjësit e departamenteve janë përgjegjës për menaxhimin e buxheteve të përcaktuara. Buxheti hartohet për të pasqyruar programin e veprimtarive, funksionet kërkimore dhe prioritetet e zhvillimit, të shqyrtuara nga Rektori dhe të miratuara nga Senati. [3; 27; 28; 1; 78; M3] Administratori mbikëqyr dhe është përgjegjës për zbatimin e buxheteve të dakorduara, dhe mbështetet nga zyra e financës; megjithatë, sistemet e reja nuk kanë qenë për një kohë të gjatë funksionale, që të mundësonin një vlerësim kuptimplotë. [13; 78; 1; M3] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohon** se krijimi i planifikuar i Bordit të Administrimit do ta lejojë Kolegjin Universitar të mbështesë zhvillimin dhe transparencën e menaxhimit financiar. Pasqyrat financiare të fundvitit i nënshtrohen auditimit të brendshëm, si në rastin e institucioneve publike të arsimit të lartë, dhe i përcillen Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. [27; 30; 113] [Kapitulli III Standard VII.1; Kapitulli III Standardet VII.2; Kapitulli III Standardi VI.1]

2.7 Mekanizmat e menaxhimit të informacionit përputhen me kërkesat statutores për mbrojtjen dhe ruajtjen e të dhënave. [31; 81] Zyra e TI-së është përgjegjëse për menaxhimin e sistemeve të komunikimeve elektronike të Kolegjit Universitar, përfshirë platformat e emailëve, që u mundësojnë stafit dhe studentëve të kenë adresa email, si dhe infrastrukturën e internetit. [129; M2; M5] I gjithë stafi dhe studentët kanë akses në një strukturë intranet me lidhje portali, nëpërmjet faqes së internetit, dhe stafi e përdor emailin dhe mjedisin virtual të të nxënësve, për të marrë informacione lidhur me mësimdhënien, si dhe përgjigjet për pyetjet e studentëve. Studentëve u sigurohen doracakë të programeve, materiale studimore dhe udhëzime lidhur me vlerësimin, nëpërmjet postës elektronike dhe kanë akses në burimet nga interneti, nëpërmjet linqeve të ofruara nga stafi. [42; 43; M2; M5; 129] Komunikimet në lidhje me aktivitetet sociale dhe kulturore janë gjithashtu të disponueshme në internet, si dhe nëpërmjet afisheve dhe njoftimeve të faqeve të internetit, për të mbështetur integrimin social. [45; 57; M2] Studentët dhe stafi pohojnë që komunikimet funksionojnë në mënyrë të efektshme dhe se iu kërkohet të japin pikëpamjet e tyre të cilat reflektohen nga struktura e mbledhjeve vendimmarrëse. [131; 130] [Kapitulli III Standardi VII.1; ESG 1.6 Burimet e të mësuarit dhe mbështetja e studentëve]

2.8 Ruajtja e të dhënave bëhet në formë elektronike dhe në formë fizike, në letër, dhe rregullimet për arkivimin e materialeve janë të përcaktuara. **[37; 81]** Njësia e Cilësisë dhe Zyra e Studentëve dhe Alumni janë përgjegjës për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore për studentët aktualë dhe mbledhjen e informacionit të vendeve të punësimit dhe ecurisë për të diplomuarit dhe alumnit, të cilat i raportohen çdo vit Ministrisë. **[97; 98; 102]** Regjistrimi i studentëve dhe menaxhimi i të dhënave të studentëve është përgjegjësi e Zyrës së Sekretarisë Mësimore, dhe notat e provimeve u vihen në dispozicion posaçërisht çdo studenti në faqen e internetit. **[129; M2; 128; 18]** Studentëve u jepet një emër përdoruesi dhe fjalëkalim, si pjesë e regjistrimit në internet, dhe akses në burime dhe korrespondencën e personelit. Rezultatet e studentëve përpunohen çdo semestër dhe regjistrat në format të shtypur dhe elektronik të kurseve përditësohen nga sekretarët e fakulteteve që e kalojnë informacionin tek sekretarët mësimore përgjegjëse për hartimin e raporteve statistikore të institucionit. **[1; 3; M2; 129]** **[Kapitulli III Standardi V.2; ESG 1.7 Menaxhimi i Informacionit]**

2.9 Stafi ka akses në kompjutera dhe programe që mbështetin mësimdhënien dhe funksionet administrative. Në mbështetje të mësimdhënies dhe të nxënies, Kolegji Universitar ka dy laboratorë kompjuterikë me tryeza për 40 studentë dhe një laborator më të specializuar të arkitekturës, që ka kapacitet për 40 studentë. **[129 [9; 32; Vizita në terren]** **[Kapitulli III Standardi VII.2]**

2.10 Kolegji Universitar ndodhet në një ndërtesë moderne në qendër të Vlorës, e cila është përshtatur, për të ofruar ambiente mësimore dhe hapësirë për zyra. Ambientet ndodhen në dy kate; në katin e dytë ndodhet hapësira kryesore e mësimdhënies, biblioteka, sallat kompjuterike, studiot dhe zyrat, ndërsa në katin e parë ndodhen hapësirat për veprimtari sociale. **[vizita në terren; 9; 36]** Ndërtesa ka rreth 2.000 metra katror hapësirë, me roje sigurimi që sigurojnë akses të autorizuar. **[32]** Hapësira mësimore përfshin pesë salla mësimore dhe një sallë leksionesh, dhjetë klasa seminari dhe tre laboratorë mësimdhënie, të cilat kanë kapacitet gjithsej prej 710 studentë në çdo moment dhe përmbushin kërkesat statutorë për sipërfaqen dhe lartësinë. **[32; Vizita në terren]** Ofrohen zyra për stafin akademik dhe personelin ndihmës. Klasat janë të pajisura me internet, një kompjuter dhe projektor. Kolegji ka plane për ndërtimin e një kampusi të ri, me qëllim përmbushjen e zgjerimeve në shërbimet e tij, përfshirë edhe kurrikulën sportive. **[12; M1; M3]** **[Kapitulli III Standardi VII.5]**

2.11 Ndërtesa menaxhohet në përputhje me kërkesat rregullatore bazë. Ambientet përmbushin kërkesat e higjienës, **[35]** dhe sallat mësimore kanë akustikë të përshtatshme si sallat e konferencave. **[130; 131]** Muret e jashtme kanë izolim termik dhe dritaret janë me xham të dyfishtë. Megjithatë, duke qenë se ndërtesa është projektuar për qëllime tregtare dhe rezidenciale, drita natyrore në sallat mësimore nuk vjen gjithmonë nga e majta, dhe në disa hapësira mësimore, veçanërisht në sallën e leksioneve, shikimi i studentëve kufizohet nga shtyllat që ka ndërtesa, dhe ndriçimi është i dobët. **[Vizita në terren; 35; 36]** Ndonëse Kolegjit Universitar ka një raport teknik për daljen e emergjencës në rast zjarri, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk mundi të identifikonte daljet e emergjencës në rast zjarri dhe vetëm vërejtë ato, nëpërmjet daljeve të jashtme në ndërtesat ngjitur, në disa raste pa kangjella ose pa mur në ballkone. Nivelet e kënaqësisë së studentëve ishin gjithashtu më të ulëta në lidhje me daljet e emergjencës në rast zjarri dhe aksesin në ashensorë dhe shkallë, krahasuar me çdo aspekt tjetër të ambienteve. **[131]** Kolegji Universitar nuk ka akses në ashensor në sallat mësimore, për staf ose studentë me probleme lëvizshmërie. **[36; vizita në terren]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një **dobësi** në konfigurimin e ndërtesës aktuale pasi nuk i përmbush të gjitha kërkesat rregullatore për ndriçimin dhe daljet e emergjencës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që Kolegji Universitar të trajtojë kërkesat e ndriçimit dhe të daljeve të emergjencës në përputhje të plotë me rregulloret. **[Kapitulli III Standardi VII.1]**

2.12 Prioritetet për përmirësimin e ambienteve dhe vlerësimin e shërbimeve bazohen në anketimet e stafit dhe studentëve. [34] Është ndërmarrë studimi i tregut për të identifikuar fushat e mundshme për zhvillimin e kurrikulave, duke përfshirë takimet me punëdhënësit, organet profesionale dhe alumni, dhe, si në rastin e ambienteve sportive, këto mbështesin Planin e Zhvillimit Strategjik. [117; 12; 15; 102; M4; 59] **[Kapitulli III Standardi VII.5; Kapitulli III Standardi VII.6]**

2.13 Ka rregullime për mirëmbajtjen e materialeve akademike dhe të trashëgimisë. Kopjet e materialeve të syllabusve, disertacioneve, botimeve shkencore dhe të dhënave të tjera të punës që lidhen me Kolegjin Universitar ruhen në bibliotekë. Stafi nxitet të publikojë pa pagesë artikuj në revistën shkencore të Kolegjit Universitar. [33; 37; 80; 104] Punimet regjistrohen në format elektronik, kur është e mundur, dhe biblioteka ka 2,900 tituj, të cilat gjithashtu i ndan me biblioteka të tjera në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Për të përmirësuar fondin e saj, biblioteka bashkëpunon me degën e Bibliotekës Kombëtare të Vlorës dhe me Kolegjin Universitar e Vlorës. Biblioteka ofron 10 kompjuterë për përdorim nga studentët dhe 20 vende studimi. **[Kapitulli III Standardi VII.4]**

2.14 Burimet aktuale janë përgjithësisht të përshtatshme për të përmbushur kërkesat e studimit nga studentët, përfshirë aksesin në kompjuter dhe sisteme të komunikimit në internet. Kolegji Universitar ka krijuar së fundmi një Bord Administrimi, për të përmbushur kërkesat ligjore të menaxhimit financiar dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet aktuale për të siguruar transparencë më të madhe në menaxhimin e buxheteve. Ndërtesa në të cilën Kolegji Universitar ndodhet aktualisht nuk i përmbush të gjitha kërkesat statutorë për daljet e emergjencës në rast zjarri, dhe ndriçimin, të cilat u identifikuan si një dobësi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që kërkesat për daljet e emergjencës në rast zjarri dhe ndriçimin duhet të trajtohen në përputhje me kërkesat statutorë.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- konfigurimi i ndërtesës aktuale pasi nuk i përmbush të gjitha kërkesat rregullatore për ndriçimin dhe daljet e emergjencës (pika 2.11; **Kapitulli III Standardi VII.1**).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- Kolegji Universitar të trajtojë kërkesat për ndriçimin dhe daljet e emergjencës, për në përputhje të plotë me rregulloret për fillimin e vitit akademik 2017-2018 (pika 2.11; **Kapitulli III Standardi VII.1**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimin e mëposhtëm tashmë në proces:

- krijimi i Bordit të Administrimit do t'i lejojë Kolegjit Universitar të mbështesë sigurimin e transparencës së menaxhimit financiar (pika 2.6; **Kapitulli III Standardi VII.1; Kapitulli III Standardi VII.2; Kapitulli III Standardi VI.1**).

Gjykim

Standardet për Burimet janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

3.1 Kolegji Universitar "Pavarësia Vlorë" ofron katër programe studimi të ciklit të parë, një program të integruar në Arkitekturë, gjashtë programe të nivelit Master të Shkencave dhe gjashtë programe të nivelit Master Profesional. **[001; 038]** Programet zhvillohen në përputhje me Procesin e Bolonjës: studimet e ciklit të parë zhvillohen me 180 kredite evropiane (ECTS) për një periudhë trevjeçare; programi i integruar në Arkitekturë ka 300 ECTS; Master i Shkencave ka 120 ECTS, ndërsa Masteri Profesional ka 60-90 ECTS. **[3 Neni 34] [Kapitulli I Standardi I.1; Kapitulli I Standardi I.10]**

3.2 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi se programet e studimit të ciklit të dytë në vijim nuk ishin licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, edhe pse studentët ishin të regjistruar në këtë programe: Master Profesional (MP) në "Financë dhe Kontabilitet", MP në "Financë dhe Bankë", MP në "Financat Publike dhe Administrata Publike", MP në "Specialist i të Drejtës për Administratën Publike", MP në "Specialist i së Drejtës për Sistemin Bankar", MP në "Specialist i së Drejtës për shoqëritë tregtare" dhe Master i Shkencave në "Inxhinieri Informatike". **[M1 ; 9]** Megjithëse Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u vu në dijeni se Kolegjit Universitar kishte bërë gjithçka që mundte për të zgjidhur çështjen me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, e konsideron këtë një dobësi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që në mënyrë të ngutshme Kolegjit Universitar dhe Ministria e Arsimit dhe e Sportit duhet të bashkëpunojnë për të zgjidhur çështjen e licencimit ende pezull për këto programe, në mënyrë që studentët e regjistruar të mund të diplomohen. **[Kapitulli I Standardi I.1]**

3.3 Programet janë hartuar në përputhje me fushat prioritare institucionale të studimit dhe kërkimit, si: ekonomia, shkencat juridike, shkencat politike, inxhinieria informatike dhe arkitektura. **[1 Neni 4]** Ka një ndërgjegjësim në rritje për nevojat e komunitetit për biznes dhe rolin e politikave të studimit të tregut në vlerësimin e kurrikulave. **[M4]** Ristrukturimi i programit të ciklit të parë në Arkitekturë, në mbështetje të restaurimit të monumenteve historike vendore, është një shembull i bashkëpunimit me punëdhënësit vendas. **[M1; M4; 48]** Kolegji Universitar po i kushton vëmendje hartimit të programeve studimore që paraqesin objektiva të qarta dhe mundësi punësimi. **[74]** Plani i Zhvillimit Strategjik parashikon profilet e reja të kualifikimit në përputhje me kërkesat e tregut, përfshirë profilet e sportit, mekatronikën, menaxhimin e turizmit mjedisor dhe arkitekturën e profilizuar. Një profil i ri i kualifikimeve të studentëve dhe kompetencave të përqendruar në treg është parashikuar në Planin e Zhvillimit Strategjik. **[12 Kapitulli 3.2]** Shumica e stafit akademik, që plotësojnë pyetësin e APAAL-it, pohuan se programet e studimit të Kolegjit Universitar janë në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe vlerësuan shumë marrëdhëniet me palët e interesi të tregut. **[130] [Kapitulli I Standardi I.3]**

3.4 Informacionet për diplomat bëhen të disponueshme, nëpërmjet faqes së internetit (<http://www.unipavaresia.edu.al/al/diplomat>), përveç kësaj Kolegji Universitar prodhon një numër të konsiderueshëm fletëpalosjesh promovuese dhe broshurash. **[93]** Institucioni organizon fushata promovuese për programet e tij të studimit në bashkëpunim me institucionet e arsimit parauniversitar, për të rritur numrin e studentëve të regjistruar. **[131; M3; 83; 96]** Përshkrimi i objektivave, planit kurrikular, kritereve të pranimit dhe përmbajtjes së kurseve është në dispozicion, dhe studentët kanë akses në faqen e internetit të Kolegjit Universitar. Objektivat e programeve të studimit janë identifikuar në programin e kursit dhe përfshijnë objektivat e të nxënësve **[M2; <http://www.unipavaresia.edu.al/al/diplomat/20-diplomat>; 42; 48; 49] [Kapitulli I Standardi I.1; Kapitulli I Standardi I.6]**

3.5 Institucioni zbaton kriteret e pranimit për programet e studimit të ciklit të parë që përcaktohen nga departamentet dhe miratohen nga Senati Akademik. Janë vendosur kritere shtesë pranimi për diplomën e integruar në fushën e drejtësisë. **[119]** Gjithashtu janë miratuar kritere pranimi për ciklin e dytë për çdo diplomë. **[M5]** Procesi i pranimit kryhet në përputhje me rregullat dhe procedurat e miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit **[84;**

39; 92 ; <http://www.unipavaresia.edu.al/al/aplikimi-ne-upv?id=25>; **61**] [Kapitulli I Standardi I.1; Kapitulli I Standardi I.6]

3.6 Politikat e vlerësimit në Kolegji Universitar përcaktohen në një sërë rregullash dhe rregulloresh. **[3 Neni 44-48]** Vlerësimi i njohurive kryhet në formë të shkruar ose me gojë bazuar në një sistem prej 0-100 pikësh. Këto konvertohen në notat 4-10, në përcaktimet Pakalueshëm-Shkëlqyer dhe në shkronjat F-A. Vlerësimi i vazhdueshëm përfshin pjesëmarrjen në leksione, diskutimet në seminare, esetë, detyrat e praktikës dhe provimet e ndërmjetme në mes të semestrit. **[3 Neni 44-48]** Autoritetet japin udhëzime për procesin e provimit dhe mbikëqyrin procedurat e tij. **[M3; 53; 3; 123]** Vlerësohen veçanërisht transparenca në provime dhe mënyra e vlerësimit të tyre nga 82.86 për qind e studentëve të intervistuar. **[131] [Kapitulli I Standardi I.1]**

3.7 Kolegji Universitar nuk ofron dëshmi për ndonjë specializim afatshkurtër, studime me kohë të pjesshme ose forma të tjera të të mësuarit gjatë gjithë jetës, edhe pse është krijuar korniza ligjore për këto, nëpërmjet statutit të ri. **[2 Neni 81]** Kolegji Universitar planifikon të organizojë një Shkollë Verore gjatë vitit akademik 2016-2017 me qëllim ofrimin e trajnimeve të vazhdueshme, për të përmirësuar kualifikimet individuale dhe aftësitë profesionale. Ai po planifikon gjithashtu të organizojë takim me alumni, për të ndarë përvojat e fituara nga të diplomuarit gjatë punësimit. **[102]** Kolegji Universitar ofron klasa pasdite për studentët e programeve të ciklit të dytë, që punojnë ose nuk janë banorë të qarkut të Vlorës. Përvojat e fituara vlerësohen gjithashtu nga Njësia e Sigurimit të Brendshme të Cilësisë, e cila vlerëson periodikisht efektivitetin e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe veprimtarive të tjera institucionale, nëpërmjet përgatitjes së raportit të vetëvlerësimit dhe anketimeve. **[2 Kapitulli XI; 10; 73]** Raporti i Vetëvlerësimit nxjerr në pah se kjo njësi duhet të përmirësojë mekanizmat e vlerësimit të cilësisë dhe efikasitetin e ngarkesës brenda dhe jashtë auditorit. **[002 fq. 28] [Kapitulli I Standardi I.2]**

3.8 Çështjet e ndërkombëtarizimit lidhen kryesisht me programin Erasmus + dhe ndërtimin e kapaciteteve të kurrikulës, nëpërmjet Programit Tempus dhe mësimit të gjuhëve të huaja (shih gjithashtu pikën 3.16). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohon** inkuadrimitin e qasjes së Kolegjit Universitar në partneritet me institucione jashtë shtetit, për shembull Erasmus +, dhe zhvillimin e trajnimeve të gjuhëve të huaja, në gjuhën angleze dhe italiane. **[80; 26] [Kapitulli I Standardi I.4]**

3.9 Ngarkesa mësimore e stafit akademik përcaktohet në legjislacionin në fuqi **[Udhëzimi Nr.20. dt. 09.05.2008]** dhe është miratuar nga Senati Akademik. Ngarkesa vjetore mësimore ndryshon sipas kategorive të kualifikimeve dhe detyrave administrative. **[2 Neni 57]** Roli i stafit akademik me kohë të pjesshme përcaktohet në përputhje me nevojat institucionale. Veprimtaritë mësimore përfshijnë leksione, seminare, ushtrime, orë laboratorike dhe praktikë profesionale. Stafi akademik me kohë të plotë mund ta tejkalojë normën vjetore mësimore pasi të ketë përmbushur të gjitha detyrimet e ngarkesës vjetore të punës. Ngarkesa e punës mësimore për anëtarët e stafit është rënë dakord nga lektori dhe përgjegjësi i departamentit dhe nënshkruhet në fillim të vitit akademik, me anë të Planit të Përparimit Akademik. **[40]** Angazhimi i strukturave të Kolegjit Universitar bën të domosdoshme krijimin e procedurës formale dokumentuese, që pasqyron harmonizimin ndërmjet mësimdhënies, punës kërkimore dhe detyrave të tjera administrative të kryera nga stafi akademik. **[Kapitulli I Standardi I.5]**

3.10 Programet e studimeve të ciklit të parë dhe të dytë harmonizohen dhe bazohen në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. **[45; 82]** Programet e ciklit të parë ofrojnë një kurrikul me orientimin profesional dhe përfshijnë informacionin bazë mbi parimet shkencore të kërkimit, që mundëson formimin e të kuptuarit të kërkimit dhe përgatit studentët për programet e studimit të ciklit të dytë. Ato përfshijnë praktikën profesionale dhe kurset e përgatitjes dhe shkrimit të tezës së diplomës. Kohëzgjatja normale e programeve të studimit

për ciklin e parë është tre vite akademike. **[3 Neni 38]** Disiplinat e programeve të studimit ndahen në pesë grupe: kurse të mirëfillta profesionale, disiplina të arsimit të përgjithshëm, disiplina të përgjithshme trajnuese, disiplina specifike trajnuese dhe disiplina të integruara trajnuese. Ato gjithashtu përfshijnë kurse me zgjedhje, të cilat përshtaten me profilin dhe preferencat e studentëve. **[3 Neni 37-38; 82]** Për të mbështetur mësimin, përdoren një sërë metodash, duke përfshirë: ekskursionë arsimore, konferenca, seminare, prezantime, takime me personalitete të shquara dhe simulime gjyqësore [Për referencë, Pika 3.18] **[Kapitulli I Standard I.7; Kapitulli I Standardi I.11; Kapitulli I Standardi I.12]**

3.11 Programet e studimit janë të organizuara në mënyrë të tillë që të mundësojnë zbatimin në praktikë të aftësive të kërkuara, nëpërmjet detyrave të kurseve, eseve, prezantimeve dhe studimeve të rastit. Shkrimi i eseve përbën 10 për qind të vlerësimit të përgjithshëm. Veprimtaritë praktike zhvillohen kryesisht në programet që lidhen me arkitekturën, shkencat juridike dhe biznesin. **[M5; 2 Neni 45; 42]** Rregullat e provimeve të diplomimit dhe procedurat e përgatitjes dhe shkrimit të tezës së diplomës janë të dokumentuara qartësisht. **[51; 82]** Departamenti vlerëson zgjedhjen e temës, metodologjinë e kërkimit dhe analizën e rezultateve për çdo mikrotezë diplomimi, në mënyrë që të vlerësojë kontributin e saj në zhvillimet prioritare vendore. Dosja e diplomimit të një studenti shqyrtohet në departament, për të parë nëse plotëson prioritetet vendore të zhvillimit. **[Kapitulli I Standardi I.7; Kapitulli I Standardi I.9; Kapitulli I Standardi I.11]**

3.12 Programet e studimit të të dy cikleve integrojnë praktikën profesionale në formë stazhi në institucionet publike dhe private. **[44; 50; 51]** Stazhet monitorohen nga stafi i Kolegjit Universitar **[M2 studentët e ciklit të parë dhe të dytë]** dhe me urdhër të dekanit është ngritur një komision i departamentit, për të vlerësuar dokumentacionin e stazhit të studentëve. **[44; 47; M3 Stafi i Lartë drejtues]** Zyra e Karrierës, Tutoriatit Studentor dhe Alumni mbështet integrimin e studentëve në tregun e punës (duke ofruar trajnime karriere) dhe ofron këshilla praktike, veçanërisht në fushat ligjore. **[M4; 131]** Sistemi i mirëzhvilluar i praktikave dhe bashkëpunimi me tregun rajonal të punësimit në Vlorë mbështet mundësitë e punësimit të studentëve pas diplomimit dhe konsiderohet nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm si shembull i praktikës së mirë. **[Kapitulli I Standardi I.7; Kapitulli I Standardi I.11; Kapitulli I Standardi I.12]**

3.13 Procedurat e transferimit të studimit janë në dispozicion të studentëve, të cilët kanë nevojë të ndryshojnë programin e tyre të studimit në përputhje me kualifikimet, aftësitë dhe përvojën e tyre. Informacioni që mundëson transferimin e programeve të studimit kryhet nëpërmjet faqes së internetit dhe nga sekretarive mësimore. **[3 Kapitulli III, Nr 43; Shembull i një dosje për një student të transferuar, M2]** **[Kapitulli I Standardi I.7]**

3.14 Kolegji Universitar ofron politika mbështetëse për përparimin e studentëve nëpërmjet orëve javore të konsultimit me pedagogë, të cilët udhëzojnë studentët në jetën e tyre akademike dhe profesionale. Një sistem tutorimi nga pedagogë kujdestarë, me një pedagog për nëntë student, lehtëson mbështetjen e studentëve, por, nga dëshmitë e disponueshme, feedback-u për tutorimin ishte i kufizuar. **[64; M2]** Për shkak të numrit të vogël të studentëve, stafi menaxhon në këtë kohë një sistem fleksibël të komunikimit me ta. Megjithatë, sistemi është aktualisht joformal dhe duhet të rikonceptohet me politika të përshtatshme, me qëllim përmbushjen e synimeve të Kolegjit Universitar për sa i përket rritjes së numrit të studentëve dhe gamës së kurrikulave. **[Kapitulli I Standardi I.8]**

3.15 Kolegji Universitar rekruton staf akademik prioritar me tituj dhe grada shkencore, që janë të angazhuar në kërkime dhe botime. Megjithatë, Kolegji Universitar është i vetëdijshëm për faktin se duhet të plotësohen disa boshllëqe në profilin e stafit. **[M3; 20; 14]** Stafi me përvojë përzgjidhet për të qenë pjesë e komisioneve të vlerësimit të programit. **[90]** U raportua se ngarkesa mësimore e programeve të studimit për vitin akademik 2016-2017 mbulohej nga 42 vetë të stafit akademik me kohë të plotë dhe 12 vetë me kohë të pjesshëm.

[001] Stafi me kohë të pjesshëm përfshin kryesisht specialistë të biznesit dhe ligjit, të cilët ftohen për të mbuluar pjesë të veçanta të kurrikulës dhe për të themeluar qasje të mësimdhënies të orientuara nga tregu i punës. **[23]** **[Kapitulli I Standard I.8; Kapitulli I Standardi I.9]**

3.16 Raportohet se asnjë student i huaj nuk ndjek kurset aktuale në Kolegjin Universitar. Institucioni nuk ofron programe studimi në gjuhën angleze. Sidoqoftë, syllabuset e Kolegjit Universitar janë të organizuar, për t'iu siguruar vëzhguesve të huaj informacione. Përmbajtja është e strukturuar në terma dhe shkalle kreditosh, duke përdorur ECTS. Pajtueshmëria me Deklaratën e Bolonjës siguron fleksibilitet në transferimin e studimeve dhe shkëmbimet e mundshëm. **[001]** Mësimi i gjuhëve zhvillohet në përputhje me strategjinë e ndërkombëtarizimit **[12]** dhe Kolegjit Universitar planifikon të krijojë një qendër gjuhësore e cila do të ofrojë trajnime në gjuhën angleze dhe italiane. **[M1]** Koordinimi i trajnimit të gjuhës menaxhohet edhe në bashkëpunim me një universitet amerikan. **[M5]** Këto gjetje mbështesin pohimin në pikën 3.8 **[Kapitulli I Standardi I.10]**

3.17 Në përfundim të programeve, lëshohen diploma për studentët e ciklit të parë dhe të dytë. Përveç diplomës, lëshohet edhe suplementi i diplomës në gjuhën shqipe dhe angleze. **[46 (10), (20)]** **[Kapitulli I Standardi I.3; Kapitulli I Standardi I.10]**

3.18 Kolegji Universitar aktualisht ka politika për përfshirjen e studentëve në aktivitetet kulturore dhe arsimore që lidhen me kurrikulën. Gjatë vizitës në terren u përmendën një numër aktivitetesh të tilla, duke përfshirë: forumet e hapura me lektorët e ftuar, tryezat e rrumbullakëta për tematika sociale të organizuara nga Unioni i Studentëve, seancat trajnuese me organizata që veprojnë në rrejet sociale, konkurse kombëtare novatore, vizita në qendrat kulturore, në ndërmarrjet turistike vendore, aplikimet në projekte vendore, trajnimet për ndërgjegjësimin e reformës ligjore, pjesëmarrjen në seanca gjyqësore dhe demonstrimi i aftësive specifike të studimit në kompani, ku zhvillohet praktika profesionale. **[M2; M3; M6; 57; 95; 125; 126]** **[Kapitulli I Standardi I.11; Kapitulli I Standardi I.12]**

3.19 Misioni i Kolegjit Universitar përqendrohet në një kurrikul që mbështet prioritetet rajonale dhe kombëtare të tregut të punës. **[12]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi praktikë të mirë në sistemin e mirëzhvilluar të praktikave dhe bashkëpunimit me tregun rajonal të punësimit në Vlorë, i cili mbështet qartësisht mundësitë e punësimit të studentëve pas diplomimit. Një dobësi e identifikuar ishte zhvillimi i disa programeve të studimit të ciklit të dytë, dhe regjistrimi i studentëve në ato programe, pa pasur licencat përkatëse nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon si çështje të ngutshme që Kolegji Universitar dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit të bashkëpunojnë për të zgjidhur çështjen ende pezull të licencimit, në mënyrë që studentët e regjistruar të mund të diplomohen. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon inkuadrimitin e qasjes së Kolegjit Universitar në partneritet me institucione jashtë shtetit, për shembull Erasmus +, dhe zhvillimin e trajnimeve të gjuhëve të huaja, në gjuhën angleze dhe italiane.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- sistemi i mirëzhvilluar i praktikave dhe bashkëpunimit me tregun rajonal të punësimit në Vlorë, që mbështet qartësisht mundësitë e punësimit të studentëve pas diplomimit (pika 3.12; **Kapitulli I Standardi I.7; Kapitulli I Standardi I.11; Kapitulli I Standardi I.12**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- zhvillimi i disa programeve të studimit të ciklit të dytë, dhe regjistrimi i studentëve në ato programe, pa pasur licencat përkatëse nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. (pika 3.2; **Kapitulli I Standardi I.1**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- në mënyrë të ngutshme, Kolegji Universitar dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit duhet të bashkëpunojnë, për të zgjidhur çështjen ende pezull të licencimit në mënyrë që studentët e regjistruar të mund të diplomohen (pika 3.2; **Kapitulli I Standardi I.1**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimin aktual tashmë në proces:

- inkuadrimi i qasjes së Kolegjit Universitar në partneritet me institucionet jashtë shtetit, për shembull me Erasmus +, dhe zhvillimeve e trajnimeve për gjuhët e huaja, në gjuhën angleze dhe italiane (pikat 3.8 & 3.16; **Kapitulli I Standardi I.4; Kapitulli I Standardi I. 10**).

Gjykim

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

4.1 Kolegji Universitar angazhohet në organizimin e efektshëm të programeve të tij të studimit. Është bërë vlerësimi i brendshëm i kurrikulës dhe dokumentacionit të saj dhe janë kryer vlerësimet e planeve mësimore vjetore. [48; 114] Stafi akademik koordinon aktivitetet e kurseve në përputhje me përmbajtjen e kurrikulës dhe rezultatet e studimit. Stafi akademik është i mirëkualifikuar, dhe përfshin gjithashtu përvojën e duhur nga biznesi. Janë ftuar edhe persona me përvojë pune, për të mbuluar kurse profesionale brenda programit mësimor. [23; 24; M4] Literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar për të gjitha programet e studimit u vihet në dispozicion studentëve, nëpërmjet programit të kursit. [42; 131] Po ndërmerren përpjekje për të përmirësuar gamën e literaturës që disponohet në bibliotekë në përmbushje të kërkesave të realizimit të kurrikulës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohon** planet e Kolegjit Universitar, që mund të zgjerojnë gamën e infrastrukturës së bibliotekës, për të mbështetur të gjitha programet e studimit, si dhe mësimdhënien, mësimnxënien dhe vlerësimin. [91; 114; M2; M3] Kolegji Universitar e ka njohur nevojën në planet e ardhshme të zhvillimit për përmirësimin e pajisjeve laboratorike, për të kryer kërkime dhe për të mundësuar qasje më praktike ndaj përmbajtjes së kurrikulës. [12; M2] [Kapitulli I Standard II.1; Kapitulli I Standardi II.3]

4.2 Programet e studimit ofrojnë përvojë përkatëse praktike, në formën e praktikave, mikrotezave të diplomimit, detyrave të praktikës, studimeve të rastit, vizitave në biznese dhe kompani, trajnimeve në aspektin e politikave sociale, juridike dhe ekonomike. Kolegji Universitar ofron një sërë lehtësirash për të mbështetur trajnimin praktik dhe formimin profesional të studentëve, duke përfshirë përgatitjen e projekteve praktike dhe teorike. [49; M3; 131 Pikat 3.13, 3.15, 3.21] Studentëve u vihen në dispozicion udhëzime mbi tezën e diplomës [51; M4] [Kapitulli I Standardi II.1]

4.3 Rregullat dhe kërkesat e provimeve miratohen dhe përshkruhen në “Rregulloren e Studimit”. Ato reflektohen në rregulloret e programeve të studimit dhe përvijohen me detaje konkrete në syllabuset e kursit. [2 Nenet: 52-54; 49; 42; M7] Procedurat e provimit janë në dispozicion në faqen e internetit të Kolegjit Universitar: (<http://www.unipavaresia.edu.al/al/sesionet-e-provimet>). Kriteret dhe procedurat e diplomimit përcaktohen në rregullore [2 Nenet: 60-62] Në lidhje me parimin e konfidentalitetit, respektohet parimi i anonimitetit, dhe rezultatet përfundimtare u bëhen të njohura studentëve, nëpërmjet sistemit elektronik të informacionit. [129] Ankesat dhe animimet për rezultatet e provimeve janë në përputhje me rregulloret e provimeve. Studentët kanë të drejtë e ankimit, në rast se janë të pakënaqur me notën. [M3; M6] Procesi monitorohet nga dekani i fakultetit. [2 Nenet: 59; 52] [Kapitulli I Standard II.2; Kapitulli I Standardi II.3]

4.4 Përmirësime shtesë në programet e studimit realizohen nëpërmjet vlerësimit të stafit pedagogjik; vlerësimi kryhet nga studentët dhe përgjegjësit e departamenteve. Ofrohet mbështetje edhe nga Zyra e Financës dhe Zyra e TI-së [54; 55; M3] Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu ofruan prova të kufizuara për feedback-un e studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies ose për planet institucionale të ndjekjes në përmirësim të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Analiza statistikore e shkallës së punësimit për alumni në funksion të vlerësimit të kurrikulës, është në një fazë të hershme zhvillimi dhe institucioni duhet të marrë në konsideratë përmirësimin e situatës në kohën e duhur. [M3]

4.5 Procedurat e trajnimit të stafit janë sporadike, bazuar në komunikimin jozyrtar midis stafit ekzistues dhe atij të ri. [M3; M4] Janë parashikuar leksione të hapura si pjesë e Planit Vjetor të Departamentit, por gjatë procesit të vlerësimit nuk është ofruar ndonjë dëshmi për këtë. [67] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk arriti të shihte një politikë ose plan të qartë në

nivel institucioni që të promovonte në mënyrë strategjike përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit. **[12; 67; 9]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideroi këtë si një **dobësi** dhe **rekomandon** zhvillimin dhe zbatimin e një politike për përmirësimin e mësimdhënies të stafit dhe cilësisë së mësimnxënies në nivelin institucioni. **[M1] [Kapitulli II Standardi I.3; Kapitulli II Standardi I.4]**

4.6 Çdo departament në Kolegjin Universitar promovon, zhvillon dhe administron detyrat themelore për menaxhimin e mësimdhënies në nivel departamenti dhe veprimtaritë kërkimore. Departamenti monitoron veprimtarinë kërkimore dhe promovimin e stafit të vet, si dhe ecurinë në aspektin e cilësisë së kërkimit. Qendra Kërkimore e Shkencave Humane dhe Qendra Kërkimore e Shkencave të Aplikuara janë organe në nivel të njësisë kryesore. **[001; 13; 115; M0]** Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk arriti të shqyrtonte dëshmi që tregonin se si qendrat e kërkimit po monitoronin kërkimin në nivel departamenti. Pati dokumente të kufizuara që tregonin nëse kryeni ndonjë vlerësim të progresit të kërkimit, ose nëse krijonin një plan për promovimin e rezultateve të kërkimit. Cilësia e kërkimit matet me numrin e botimeve dhe faktorin e ndikimit të kërkimit, në lidhje me cilësinë dhe reputacionin e botimit. **[M5; 131]** Veprimtaria shkencor i qendrave kërkimore raportohet se mbështetet nga thirrjet për aplikime në projekte. Megjithatë, siç përmendet edhe në Raportin e Vetëvlerësimit, ka pasur një mungesë fondesh dhe disa nga aplikimet nuk janë realizuar. **[002 Kapitulli II Standardi I.2; M1]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pati mundësi të shihte shumë dëshmi të projekteve kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare që të mbështesin nxitjen e një aktiviteti kërkimor dinamik; një gjetje që mbështet gjykimin e bërë në pikën 4.11 më poshtë. **[80] [Kapitulli II Standardi I.1; Kapitulli II Standardi I.2; Kapitulli II Standardi I.4; Kapitulli II Standard I.8]**

4.7 Monitorimi i veprimtarisë kërkimore ndërmerret gjithashtu nga departamenti dhe vlerësohet në baza vjetore, duke vlerësuar performancën e secilit pedagog. Pedagogët dorëzojnë në mënyrë periodike në departamentin e tyre një "Plan të Përparimit Akademik" **[40; M5]** në të cilin ata deklarojnë progresin me kërkimin shkencor dhe planet e ardhshme. Në fund të vitit, përgjegjësi i departamentit kryen vlerësimin e performancës për secilin anëtar të stafit, **[55]** si pjesë e Raportit Vjetor të Veprimtarisë Kërkimore-Shkencore. **[25; 56; M3]** Dokumentet e ofruara për të mbështetur këtë lidhen kryesisht me cilësinë e mësimdhënies ose listat e botimeve të stafit akademik; ato nuk reflektojnë ndonjë vlerësim të procedurave të cilësisë së kërkimit, apo planit të veprimit për zhvillimin strategjik. Kjo papërshtatshmëri kufizon zbatimin e strategjisë kërkimore të përmendur në pikën 4.11 **[Kapitulli II Standardi I.1]**

4.8 Plani i Zhvillimit Strategjik 2015-2020 përcakton bashkëpunimin ndërkombëtar, konferencat, botimet, simpoziumet shkencore, tryezat e rrumbullakëta dhe forume diskutimi, si tendencat prioritare për profilin kërkimor të institucionit. **[12; M3; 67]** Prioritetet e kërkimit të përcaktuara si prioritetet shkencore të departamentit (shih pikën 4.11 më poshtë) në dokumentet e mësipërme, përqendrohen kryesisht në veprimtaritë në të cilat përfshihen studentët gjatë pjesëmarrjes së tyre në zhvillimin e kurrikulës. **[M1; 56; M5][Kapitulli I Standardi II.4]**

4.9 Stafi akademik merr pjesë në veprimtaritë shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe publikon dokumente në revista shkencore ndërkombëtare, si pjesë e promovimit të tyre individual shkencor. **[25; 108; M3]** Bashkëpunimi me Institutin Kanadez të Teknologjisë, Qendrën "EPIKT", në Shqipëri dhe institucionet kombëtare ose ndërkombëtare të arsimit të lartë, i ka mundësuar Kolegjit Universitar të organizojë ose të marrë pjesë në ngjarjet shkencore ndërkombëtare dhe të promovojë punën e stafit të vet. **[11; 16; 17; 65]** Institucioni ka organizuar një konferencë shkencore ndërkombëtare në ambientet e tij dhe publikon revistën e vet "PAVARESIA", për të nxitur debatin shkencor në fushat prioritare të kërkimit. Revista dhe botimi i konferencës janë shembuj të pronësisë intelektuale dhe promovimit të kërkimit të Kolegjit Universitar në nivel ndërkombëtar. **[89; 8; 7; 58; M5]**

Megjithatë, përpjekjet e ndërkombëtarizimit të Kolegjit Universitar duket se janë shumë modeste dhe të kufizuara në pjesëmarrjen e stafit akademik në veprimtaritë shkencore ndërkombëtare, kryesisht në konferenca. Projektet ndërkombëtare të përmendura nuk duket se përbëjnë veprimtari kërkimore të qëndrueshëm dhe të referuar, që mbështet në këtë mënyrë gjetjet e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (shih pikën 4.11 më poshtë) **[Kapitulli II Standardi I.2; Kapitulli I Standardi I.3; Kapitulli II Standardi I.4; Kapitulli II Standardi I.7]**

4.10 Kolegji Universitar synon të rekrutojë pedagogë të kualifikuar që të jenë aktivë në kërkime në fushat e ofruara nga institucioni dhe që kanë kryer kualifikime jashtë shtetit. Për rekrutimin e stafit, i jepet përparësi kriterëve të gradave shkencore dhe botimeve kërkimore. **[M5; 20; 21]** Trembëdhjetë anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë kanë ndjekur studime Bachelor, Master ose Doktoraturë jashtë vendit. **[88]** Kolegji Universitar i nxit studiuesit e rinj, duke promovuar kërkimin e tyre në veprimtaritë shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. **[130]** Teza e diplomës së ciklit të dytë ndërmerret, miratohet dhe vlerësohet në bazë të ndikimit të saj në zhvillimet vendore. **[M4]** Stafi merr mbështetje për tarifën e konferencës ose tarifën e pjesëmarrjes në aktivitetet profesionale, që paguhen nga Kolegji Universitar. **[M5; 63]** Ka politika mbështetëse për mobilitetin e studiuesve në studime postdoktorale. **[6; M1, M3]** Stafi akademik me kohë të plotë nuk është i detyruar të paguajë ndonjë tarifë, për të botuar në revistën e Kolegjit "PAVARËSIA". Kolegji Universitar planifikon të ndërtojë një bazë të dhënash online për veprimtarinë kërkimore të stafit, që do të vihet në dispozicion në faqen e internetit të Kolegjit Universitar, por nuk u dha u vu në dispozicion asnjë dëshmi gjatë prezantimit të mjedisit virtual të të nxënësve. **[002 Kapitulli II Standard I.7] [Kapitulli I Standardi I.5; Kapitulli II Standardi I.6; Kapitulli II Standardi I.7; Kapitulli II Standardi I.8]**

4.11 Për arsye se nuk ka kohë të gjatë që vepron si një institucion i arsimit të lartë, Kolegji Universitar ende nuk ka zhvilluar një profil të fuqishëm kërkimi në drejtim të përcaktimit të prioritetëve kërkimore shkencore. **[12]** Politika e tij e bashkëpunimit me institucionet kombëtare të kërkimit është në një fazë të hershme dhe dëshmitë tregojnë angazhimin modest në hartimin dhe zbatimin e politikave shkencore rajonale dhe kombëtare. **[80]** Bashkëpunimi kërkimor me bizneset vendore, rajonale dhe të huaja, si edhe aktivitetet ekonomike dhe sociale nuk janë shumë të zhvilluara. **[12]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e vlerësoi mungesën e një strategjie kërkimi të inkuadruar, të mbështetur nga politika monitorimi të mirëpërcaktuara, si një **dobësi**, dhe **rekomandon** që Kolegji Universitar të zhvillojë një qasje strategjike për menaxhimin, zbatimin dhe përparimin e prioritetëve të kërkimit në nivel institucional. **[Kapitulli II Standardi I.1-8]**

4.12 Përgjegjësitë për menaxhimin e mësimdhënies, mësimnxënies, vlerësimit dhe kërkimit janë përcaktuar në Planin Strategjik të Zhvillimit 2015-2020. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristike të praktikës së mirë. U identifikuan dobësitë si më poshtë: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk mundi të shihte një politikë të qartë në nivel institucional, që promovonte në mënyrë strategjike përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit. Përveç kësaj, qasja e Kolegjit Universitar ndaj kërkimit është në një fazë të hershme zhvillimi, dhe aktualisht i mungon një qasje e menaxhimit institucional për kërkimin dhe i mungojnë strukturat për zhvillimin e prioritetëve për sa i përket rritjes së profilit të tij kërkimor vendor dhe kombëtar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që Kolegji Universitar të zhvillojë dhe të zbatojë në nivel institucional një politikë për përmirësimin e mësimdhënies të stafit dhe cilësisë së mësimnxënies dhe Kolegjit Universitar të zhvillojë një qasje strategjike për menaxhimin, zbatimin dhe përparimin e prioritetëve të kërkimit në nivel institucional. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi zgjerimin e infrastrukturës së bibliotekës, për të mbështetur të gjitha programet e studimit dhe për të mbështetur mësimdhënien, mësimnxënien dhe vlerësimin.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk mundi të shihte një politikë të qartë në nivelin e Kolegjit Universitar, që promovonte në mënyrë strategjike përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit (pika 4.5; **Kapitulli II Standardi I.3; Kapitulli II Standardi I.4**)
- qasja e Kolegjit Universitar ndaj kërkimit është në një fazë të hershme zhvillimi dhe aktualisht i mungon një qasje institucionale ndaj kërkimit dhe strukturave për zhvillimin e prioritetëve dhe rritjen e profilit kërkimor vendor dhe kombëtar. (pika 4.11; **Kapitulli II Standardi I.1-8**).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Kolegji Universitar, gjatë vitit 2017-2018, të zhvillojë dhe zbatojë një politikë për përmirësimin e mësimdhënies së stafit dhe cilësisë së të nxënësve (pika 4.5; **Kapitulli II Standardi I.3; Kapitulli II Standardi I.4**)
- Kolegji Universitar, gjatë vitit 2017-2018, të zhvillojë një qasje strategjike për menaxhimin, zbatimin dhe përparimin e prioritetëve të kërkimit në nivel institucional (pika 4.11; **Kapitulli II Standardi I.1-8**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimin e mëposhtëm tashmë në proces:

- zgjerimi i infrastrukturës së bibliotekës për të mbështetur të gjitha programet e studimit dhe për të mbështetur mësimdhënien, mësimnxënien, vlerësimin (pika 4.1; **Kapitulli I Standardi II.3; Kapitulli I Standardi II.1**).

Gjykim

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur pjesërisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

5.1 Kuotat e pranimeve përcaktohen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit së bashku me kriteret kryesore të pranimi, të cilat zbatohen nga Kolegji Universitar në përputhje me kërkesat statutores. Pranimi i studentëve në programet e studimit përcaktohet në Politikën e Pranimeve dhe parashikohet në nenet 71 dhe 76 të ligjit për arsimin e lartë. Në Statut përcaktohen kriteret dhe proceset gjithëpërfshirëse për pranimet në programet universitare dhe pasuniversitare. **[1 Nenet 64 dhe 76; 3; M6]** Në rastet kur aplikantët kanë të njëjtat nivele të arritjeve shkollore, ata renditen në bazë të kriterëve shtesë të zbatuara nga Senati dhe në fund aplikimet shqyrtohen nga Rektori. **[92; 61; 62; 39]** Përshkrimet e programeve janë në dispozicion në faqen e internetit të Kolegjit Universitar si dhe përmes broshurave të shpërndara në shkollat e mesme. **[40 - 42,4; 93; M2]** Zhvillohen ditë të hapura për aplikantët e interesuar dhe biseda me nxënës të shkollave të mesme; studentët kanë raportuar se janë të kënaqur me qartësinë dhe gamën e informacionit që kanë marrë. **[59; 84; M6; 131; M2]** Studentët e huaj janë të mirëpritur nga Kolegji Universitar dhe ka procedura për të lehtësuar aplikimet, ndonëse në kohën e vizitës, në Kolegjin Universitar nuk studionte asnjë student i huaj. Raporti staf-student tejkalon kërkesat minimale, dhe stafi aktual përfaqëson një pedagog për çdo nëntë studentë. **[001; 9] [Kapitulli I Standardi III.1; Kapitulli I Standardi III.4]**

5.2 Instruktimi i studentëve, mbështetja e studentëve dhe këshillimi është organizuar në mënyrë të efektshme, me përgjegjësi të përgjithshme për informim dhe planifikim që mbulohet nga Zyra e Karrierës, Tutoriatit Studentor dhe Alumni. **[94; 96; 59; M2; M6; 114]** Ka procese për transferimin e studentëve që dëshirojnë të transferohen nga institucionet e tjera ose të transferohen në programe të jashtme, në përputhje me rregulloret statutores dhe procedurat e brendshme. **[1; 3; 43; M2]** Informacioni për programet që ofrohen nga Kolegji Universitar publikohet në faqen e internetit midis qershorit dhe gushtit, së bashku me detajet e procedurave dhe formularëve të aplikimit, për të cilat studentët u shprehën se janë të qarta dhe të arritshme. **[131; M3]** Zyra e Karrierës, Tutoriatit Studentor dhe Alumni gjithashtu ndjek punësueshmërinë e studentëve dhe ndihmon të diplomuarit në përgatitjen dhe gjetjen e punësimit, nëpërmjet ndërveprimit të vazhdueshëm me punëdhënësit **[9; 97; 102; M2; M6] [Kapitulli I Standardi III.3; Kapitulli I Standardi III.9]**

5.3 Kopjet e orareve u vihen në dispozicion studentëve nëpërmjet Zyrës së Financës, bibliotekës, sekretarive mësimore dhe faqes së internetit. **[129; M2]** Gjatë javës së orientimit, studentëve u ofrohet informacion rreth programit të tyre, përfshirë doracakëve, specifikimet e kursit dhe kërkesat e studimit. **[96; 114; M2]** Oraret e mësimdhënies përcaktohen dhe miratohen para fillimit të secilit semestër, dhe studentët pohuan se janë të qarta dhe të aksesueshme. **[3; 45; M5; 131]** Numri mesatar i orëve të mësimdhënies në auditor për programet universitare rakordohet në përputhje me marrëveshjet e ngarkesës mësimore të stafit dhe strategjinë për mësimdhënie, mësimnxënie dhe kërkim. **[85; 83; 79]** Studentëve u mundësohet kujdestari pedagogjike për secilin prej tre viteve universitare, dhe si pjesë të ofrimit të studimeve pasuniversitare. Secili pedagog ka një grup të vetin në kujdestari, që u jep mësim, dhe harton raporte mujore. **[64; 61; M5; M2; 79]** Raportet e përgatitura nga stafi akademik i dorëzohen Përgjegjësit të Departamentit, i cili raporton për ecurinë dhe prioritetet e reja në Senatin Akademik. Raportet përfshijnë angazhimin e studentëve në veprimtari akademike dhe joakademike. **[55; 79; 9; M5; 1]** Sekretaritet mësimore të fakultetit janë përgjegjëse për mbajtjen e dosjeve të studentëve të cilat përfshijnë të dhënat e kontaktit të tyre personal dhe të dhënat që lidhen me arritjet dhe ecurinë. **[Shembull i bazës së të dhënave me të dhënat e studentëve; 61] [Kapitulli I Standardi III.2]**

5.4 Kolegji Universitar ka dispozita të qarta për mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve. Studentët marrin orientime dhe mbështetje për studimet gjatë orës së parë në auditor dhe mund të kërkojnë sqarime dhe udhëzime shtesë nga pedagogët, qoftë edhe në

mënyrë joformale ose nëpërmjet komunikimit me email me titullarët e lëndëve, siç pohohet nga nivelet e larta të kënaqësisë të evidentuara në anketimin e studentëve, ku 95 për qind raportuan se stafi ishte i disponueshëm dhe i dobishëm. **[131; M2]** Mbështetja mësimore sigurohet nga Zyra e Karrierës, Tutoriatit Studentor dhe Alumni, për të përmbushur nevojat individuale të të nxënit. **[M2; M5; 45]** Studentët kanë akses në notat e tyre dhe feedback-un e tyre, nëpërmjet raporteve në internet, dhe studentët pohuan se reagimet dhe rezultatet ishin të qarta, në kohën e duhur dhe të aksesueshme. **[M2; 114; 129]** Duke qenë se i gjithë stafi ka adresa emaili për Kolegjin Universitar, studentët mund të kontaktojnë direkt stafin akademik dhe të kërkojnë informacione, sqarime dhe feedback sipas rastit. **[129; M2; 114; M5]** **[Kapitulli I Standardi III.3; Kapitulli I Standardi III.6]**

5.5 Studentët mbështeten në mënyrë të efektshme për të zhvilluar praktika profesionale nëpërmjet marrëveshjeve ndërmjet Kolegjit Universitar dhe punëdhënësve. Kolegji Universitar ka zhvilluar një rrjet me punëdhënës, me të cilët punon për të mbështetur punësueshmërinë e studentëve. **[103; 11; M2; M4]** Studentët pohuan se Zyra e Karrierës, Tutoriatit Studentor dhe Alumni ofron informacion për planifikim për praktikën profesionale dhe mbështet studentët në plotësimin e aplikimeve për praktikën; Anketimi i Studentëve tregoi se 92 për qind e të anketuarve mendonin se mbështetja që ata marrin është e mirë ose shumë e mirë. **[97; 59; 65; 131]** Studentët nxiten gjithashtu të marrin pjesë në projekte të jashtme, për të zgjeruar mundësitë dhe njohuritë e tyre; për shembull, Projekti “Modele Suksesi”, i cili u përqendrua në caktimin e studentëve në kompani dhe në institucione publike, për të zgjeruar njohuritë për sa i përket politikave dhe praktikave që lidhen me fushën e tyre të studimit. **[66; 65]** Zyra e Karrierës, Tutoriatit Studentor dhe Alumni grumbullon të dhëna për alumnit dhe punësimin e të diplomuarve, që përdoren nga Kolegji Universitar si pjesë e procesit të vlerësimit strategjik dhe planifikimit. **[Kapitulli I Standardi III.9]**

5.6 Zyra e Karrierës, Tutoriatit Studentor dhe Alumni ofron informacione, këshilla dhe udhëzime për studentët rreth shkollave verore dhe kurseve të trajnimit. Studentët, që ndjekin shkollat verore dhe kurset e shkurtra, marrin certifikata pjesëmarrjeje. **[66; 114; Studentët]** Si pjesë e përvijës më të gjerë institucionale, studentëve u ofrohet informacion për aktivitetet shoqërore dhe kulturore, si dhe për seminare dhe konferenca, nëpërmjet faqes së internetit. Informacione të mëtejshme bëhen të disponueshme në ekranet e televizorëve të brendshëm dhe me anë të posterave të afishuar në ambientet të Kolegjit Universitar. Aty ku studentët janë të angazhuar në projekte të jashtme, ofrohet mbështetje financiare për shpenzime të udhëtimit dhe shpenzime të tjera. **[126; 95; 63; 125; 124]**

5.7 Angazhimi i studentëve në vendimmarrje nxitet në mënyrë të efektshme, nëpërmjet Këshillit të Studentëve dhe përfaqësimit në komitetet e Kolegjit Universitar. Studentët zgjedhin përfaqësuesit në Këshillin e Studentëve dhe përfaqësohen nga Presidenti Studentor në Senatin Akademik dhe nga përfaqësues të emëruar në Këshillat e Fakultetit. **[1; M1]** Studentët kanë akses në vendimet e Kolegjit Universitar, nëpërmjet intranetit. **[1; 125; M2]** Studentët nxiten gjithashtu të marrin pjesë në një sërë aktivitetesh ekstrakurrikulare, përfshirë sportet, turnetë e shahut dhe aktivitete për mbledhjen e fondeve. Studentët kanë marrë pjesë në mbledhjen e fondeve për fëmijë nga shtresa të pafavorizuara, projekte mjedisore dhe në mbështetjen për grupet e cënueshme. **[63; 95; 80; M2]** Kolegji Universitar siguron një buxhet vjetor, për të mbështetur aktivitetet e studentëve që drejtohen nga Unioni Studentor. **[1; 3; 63]** **[Kapitulli I Standardi III.7; Kapitulli I Standardi III.8]**

5.8 Kolegji Universitar ofron bursa dhe mbështetje për studentët nga grupet e pafavorizuara shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar. **[62; 1; 5]** Kriteret shqyrtohen dhe rishikohen çdo vit nga Senati, sipas nevojës. **[62; 84; 92]** Studentët e përkatësisë etnike rome dhe egjiptiane, së bashku me studentët që përmbushin kriteret e “ekselencës”, përfitojnë 100 për qind të pagesës së tarifave, si edhe studentët që kanë

pësuar humbje të familjarëve, studentët me nevoja të veçanta dhe fëmijët e oficerëve të policisë që kanë humbur jetën në krye të detyrës. **[62; 1; 3]** Studentët nga grupet e identifikuar që studiojnë në nivelin pasuniversitar, përfitojnë 50 për qind të pagesës së tarifave. Në vitin 2015-2016, Kolegji Universitar ka përjashtuar 12 studentë romë dhe egjiptianë dhe 13 studentë, prindërit e të cilëve kishin humbur jetën gjatë shërbimit në polici, nga pagesa e tarifës shkollore. Megjithatë, siç theksohet në pikën 2.11, nuk lehtësohet aksesimi për studentët me aftësi të kufizuara fizike. **[28; 9] [Kapitulli I Standardi III.4]**

5.9 Studentët kanë akses në bibliotekë, e cila ka 2,900 tituj në dispozicion përfshirë tekste, doracakë, artikuj dhe tekste në internet, që mbulojnë të gjitha fushat e lëndëve. **[91; M2]** Kolegji Universitar e rishikon vazhdimisht stokun e librave dhe çdo muaj shtohen libra, që plotësohet më tej nga shkëmbimi i burimeve me biblioteka të tjera në nivel vendor dhe sipas nevojës jashtë vendit. **[9; 27; 103; M6]** Biblioteka gjithashtu ka kopje të disertacioneve dhe tezave të studentëve, si dhe punimet kërkimore të botuara nga stafi; megjithatë, siç u përmend më lart në raport, burimet janë të kufizuara. **[104; M6]** Studentët mund të përdorin materiale nga dega e Bibliotekës Kombëtare të Vlorës, dhe, nëpërmjet marrëveshjeve, me Kolegjin Universitar të Vlorës. **[103; M2]** Biblioteka e Kolegjit Kolegji Universitar është e hapur 10 orë çdo ditë, përveç të dielave, dhe u siguron studentëve hapësira studimi dhe mbështetje për të aksesuar dhe për të printuar materialet. **[Vizita në terren; M6; 91]** Studentët shprehën pozitivisht lidhur me aksesin në burime dhe materiale, të cilat plotësohen nga materiale online të ofruara nga pedagogët. **[M2; M5; 131] [Kapitulli I Standardi III.5; Kapitulli I Standardi III.8]**

5.10 Studentët kanë akses në një gamë të gjerë informacionesh për programet, të publikuara në faqen e internetit të Kolegjit Universitar. Angazhimi i studentëve me menaxhimin realizohet nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur në Këshillin Studentor, të cilët përfaqësojnë zërin e studentëve në komisionet kryesore, duke përfshirë Senatin Akademik. Aktivitetet e organizuara nga Këshilli Studentor marrin mbështetje financiare nga Kolegji Universitar dhe studentët nxiten gjithashtu të marrin pjesë në projekte të jashtme. Janë dhënë informacione të qarta për mundësitë e zhvillimit të praktikës nga Zyra e Karrierës, Tutoriatit Studentor dhe Alumni, që gjithashtu mban kontakte me të diplomuarit dhe mbështet studentët për të gjetur punë. Burimet e bibliotekës në kampus plotësohen nga aksesimi në bibliotekat e afërta publike dhe të institucioneve të tjera. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë praktikë të mirë apo dobësi, nuk dha rekomandime dhe nuk bëri pohime për këtë fushë vlerësimi.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi.

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha ndonjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi ndonjë veprim tashmë në proces.

Gjykim

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht.

Lista e dokumenteve

Nr. Dokumentet ose dëshmitë
001 Informacione të përgjithshme dhe të dhëna për Kolegji Universitar
002 Raporti i Vetëvlerësimit i KUPV
Nr. 1. Statuti i SHPALPV
Nr. 2. Statuti i KUPV
Nr. 3. Rregullore e SHPALPV
Nr. 4. Vendimi i rektorit për ngritjen e grupit
Nr. 5. Kodi i Etikës së SHPALPV
Nr. 6. Kërkesë për leje akademike postdoktorale
Nr. 7. Gazeta Shkencore "Pavarësia"
Nr. 8. Libri i Procedurave të Konferencës
Nr. 9. Raporti Vjetor Institucional 2015-2016
Nr. 10. Rregullore e NjSBC-së
Nr. 11. Marrëveshje Bashkëpunimi me Qendrën Kombëtare Epic Albania, TreCon IT
Nr. 12. Plani Strategjik i Zhvillimit të SHPALPV për periudhën 2015 - 2020
Nr. 13. Organizimi i KUPV
Nr. 14. Struktura analitike e KUPV
Nr. 15. Pyetëtori për Alumni
Nr. 16. Marrëveshja e bashkëpunimit me Studio Private të Arkitekturës ASI
Nr. 17. Marrëveshja e bashkëpunimit me Universitetin "La Sapienza", Romë
Nr. 18. Mbrojtja dhe përpunimi i të dhënave
Nr. 19. Raporti i projektit "ENCHASE"
Nr. 20. Procedura e rekrutimit (shembull)
Nr. 21. Formulari i aplikimit për stafin akademik
Nr. 22. Lloji i kontratës me kohë të plotë për stafin akademik
Nr. 23. Lista e stafit akademik të jashtëm dhe atyre të ftuar për vitin akademik 2016 - 2017
Nr. 24. CV e stafit akademik të ftuar, Arlind AHMETAJ
Nr. 25. Raporti i kërkimit shkencor për 2015-2016
Nr. 26. Mandati për aplikim në programin Erasmus Plus me Universitetin "Leon", Spanjë
Nr. 27. Buxheti financiar për vitin 2017
Nr. 28. Bilanci për vitin 2016
Nr. 29. Fatura për Raportin e Auditimit të Brendshëm 2016
Nr. 31. Rregullorja për "Përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe aplikimin e saj në CCTV"
Nr. 30. Rregullore për "Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale"
Nr. 32. Dokumentet në lidhje me pronat me qira nën administrimin e KUPV
Nr. 33. Memo për përjashtimin e stafit të brendshëm akademik nga tarifa e botimit në revistën shkencore
Nr. 34. Pyetëtori i Përgjithshëm i zhvilluar nga NjSBC-ja
Nr. 35. Leja Sanitare e IAL
Nr. 36. Raporti Teknik për Mbrojtjen nga Zjarri
Nr. 37. Rregullore e Arkivit për rregullat profesionale-teknike dhe procedurat metodologjike për shërbimin arkivor në KUPV
Nr. 38. Lista e programeve të studimit
Nr. 39. Vendimi i Senatit për kriteret shtesë të propozuara për regjistrimin e studentëve në ciklin e parë dhe të dytë
Nr. 40. Plani i Përparimit Akademik dhe shembulli i Planit të Përparimit Akademik
Nr. 42. Syllabusi i Ekonomikut
Nr. 42.1 Syllabusi i Matematikës

Nr. 42. 3 Programi i Kursit Menaxhim Marketingu
Nr. 42.4 Programi i Kursit Analiza Statistikore
Nr. 43. Shembull i një dosje për student të transferuar
Nr. 44. Urdhri i Dekanit për ngritjen e Komisionit për Vlerësimin e Praktikës së Studentit
Nr. 45. Shembull i një Kurrikule
Nr. 46. Shembull i Suplementit të Diplomës (1)
Nr. 46. Shembull i Suplementit të Diplomës (2)
Nr. 47. Dosja e studentit për Periudhën e Praktikës Profesionale
Nr. 48. RVV për Bachelor në Ekonomi
Nr. 48.1 RVV për Bachelor në Informatikë
Nr. 48.2 RVV për Master në Inxhinieri Kompjuterike
Nr.48.3 RVV për Master në Ekonomi
Nr. 49. Rregullore e Programit të Studimit në Drejtësi
Nr. 50. Shembull i Marrëveshjes me një Institucion tjetër për Praktikën Profesionale të Studentëve
Nr. 51. Manuali i tezës së diplomës
Nr. 52. Urdhër për zhvillimin dhe vlerësimin e provimeve
Nr. 53. Vendimi i Senatit për Miratimin e Ndryshimeve në Kurrikul
Nr. 54. Pyetësori i vlerësimit për pedagogun, hartuar nga studentët
Nr. 55. Formulari i vlerësimit për pedagogun nga Përgjegjësi i Departamentit
Nr. 56. Planifikimi i Kërkimit Shkencor i Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike
Nr. 57. Poster i një Leksioni të Hapur me Lektorin e Ftuar, Arlind AHMETAJ
Nr. 58. Vendimi i Senatit Akademik për Këshillin Botues
Nr. 59. Raport për aktivitetet informuese nga CSTAO
Nr. 61. Shembull i një dosje studentore
Nr. 62. Vendimi i Senatit për Miratimin e Bursave për Kategoritë e Studentëve të Veçantë
Nr. 63. Memo për Mbështetje Financiare
Nr. 64. Raport për tutorimin
Nr. 65. Marrëveshje Bashkëpunimi me UET
Nr. 65. Marrëveshje bashkëpunimi në fushën e trashëgimisë kulturore
Nr. 66. Certifikata e lëshuar nga IAL
Nr. 67 Plani Vjetor i Punës së Institucionit, për vitin akademik 2016 - 2017 (Dok. Plotësues)
Nr. 68 Marrëveshje Bashkëpunimi në fushën e Kulturës së Trashëgimisë (Dok. Plotësues)
Nr. 69 Relacion, dt. 10.11.2016, "Pjesëmarrja e studentëve në konkursin" Unë zgjedh të flas- Shkruaj dhe Fito" (Dok. Plotësues)
Nr. 27. Buxhet financiar për vitin 2015 - 2016
70. Raport i Vlerësimit të Brendshëm Institucional
Dokumente shitesë të siguruara
Nr. 71. Shembull procesverbali për vendimmarrje institucionale.pdf
Nr. 72. Plani i veprimit për rekomandimet e Urdhrit nr. 340, datë 8.06.2012.pdf
Nr. 73. Shembull i veprimtarisë NjSBC.pdf
Nr. 74. Studimi për kërkesat e programeve të edukimit fizik dhe sportit
Nr. 75. Detyra e Këshillit të Mirëbesimit
Nr. 76. 14 procedura për rekrutimin, përshkrimi i punës
Nr. 77. Pyetësori për Alumni
Nr. 78. Bordi i Administrimit
Nr. 79. Përmbledhje e raportit vjetor për veprimtaritë mësimore dhe kërkimore
Nr. 80. Lista e projekteve
Nr. 81 Procedurat e Mbrojtjes së të Dhënave
Nr. 82. Rregullore e programit Bachelor në Drejtësi
Nr. 82. Shembull i ngarkesës mësimore të programit
Nr. 83. Marrëveshje Bashkëpunimi me një shkollë të mesme

Nr. 84. Rregulloret dhe procedurat për pranimet e studentëve
Nr. 85. Përmbledhje e strategjisë për mësimdhënie, mësimnxënie dhe vlerësim
Nr. 86. Shembull i procesit dhe rezultateve të miratimit për një program studimi - Këshilli i Fakultetit dhe Senati Akademik
Nr. 87. Përmbledhje e strategjisë së kërkimit lidhur me zhvillimin e pedagogjisë
Nr. 88. Staf i kualifikuar jashtë vendit
Nr. 89. Kopje e programit të konferencës evropiane
Nr. 90. Procedurat për vlerësimin e një programi studimi në zbatim të ndryshimeve
Nr. 91. Biblioteka, baza e të dhënave dhe pasurimi i tyre
Nr. 92. Praktikantët e pranimit, kriteret shtesë dhe kuotat
Nr. 93. Broshura
Nr. 94. Grafiku i veprimtarive të rekrutimit 2016 - 2017
Nr. 95. Shembull i veprimtarive të Unionit Studentor
Nr. 96. Java e Orientimit
Nr. 97. Raporti i CSTAO - këshilla për përparimin dhe karrierën
Nr. 98. Modeli i pyetësorit për Alumni
Nr. 99. Shpjegimi i përzgjedhjes së stafit të lartë
Nr. 100. Periudhat e emërimit dhe dispozitat për stafin
Nr. 101. Statusi i Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike
Nr. 102. Takimi i Zyrës së Karrierës me të diplomuarit
Nr. 103. Lista e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit
Nr. 104. Lista e veprimtarive kërkimore në 3 vitet e fundit
Nr. 105. 1 Kërkesë për mbështetjen në lidhje me pagesën e tarifës së shkollimit
Nr. 105. 2 Ngritja e Grupit të Vetëvlerësimit
Nr. 106. Marrëveshje Bashkëpunimi - La Sapienza, Romë
Nr. 107. Deklaratë që pohon rregullimet e auditimit
Nr. 108. Lista e veprimtarive kërkimore në 3 vitet e fundit
Nr. 109. Plani vjetor për rekrutimin e stafit akademik
Nr. 110. Rregulloret për TI-së dhe përdorimin e CCTV
Nr. 111. Shembuj të kartelave të kujdesit shëndetësor
Nr. 112. Protokollet e Arkivimit
Nr. 113. Deklarata e auditimit të brendshëm
Nr. 114. Përmbledhje e studimit të anketimit
Nr. 115. Kualifikimet kërkimore të stafit me kohë të plotë
Nr. 116. Lista e institucioneve që mbështesin punën në terren për programet Master
Nr. 117. Studim tregu për kërkesën për arsimin e lartë
Nr. 118. Lista e programeve të studimit
Nr. 119. Vendimi për kërkesat e pranimit në programet e integruara në Drejtësi
Nr. 120. Vendimi për Diplomën Master Profesional në Ekonomi
Nr. 121. Tema e tezës së diplomës
Nr. 122. Vendimi i Senatit për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Bordi Editorial i Revistës Shkencore
Nr. 123. Vendimi i Procesit të Provimit
Nr. 124. Kërkesë për financim për udhëtimin e studentëve
Nr. 125. Përmbledhje e mbështetjes për aktivitetet e Unionit Studentor
Nr. 126. Aktivitete ekstrakurrikulare
Nr. 127. Lista e stafit sipas departamentit me të dhëna për kualifikimin
Nr. 128. Rregulloret për sistemet SMI dhe TI
Nr. 129. Demonstrim i VLE
Nr. 130. Anketimi i stafit - Konsiderata të larta për menaxhimin e Kolegjit Universitar
Nr. 131. Anketimi i studentëve – Konsiderata të larta për menaxhimin e Kolegjit Universitar
Nr.
Mbledhjet

M0	Lehtësuesi dhe grupi i vetëvlerësimit
M1	Rektori
M2	Studentët e Ciklit të 1 ^{rë} dhe 2 ^{të}
M3	Stafi i lartë drejtues
M4	Punëdhënësit dhe Alumni
M5	Stafi Mësimor dhe Kërkimor
M6	Personeli mbështetës